

Tetor 2025 | Nr. 53

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i Drejtësisë



@ILD_Albania



Inspektori i Lartë i Drejtësisë

FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PARA KUVENDIT MBI VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT PËR VITIN 2024





FJALA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PARA KUVENDIT MBI VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT PËR VITIN 2024

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë,

Si çdo vit, po paraqes para këtij Kuvendi informacionin për veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2024. Ju e keni raportin përpara dhe shifrat dhe të dhënat gjenden atje dhe nuk do të doja të isha përsëritës i shifrave të shkruara në raport. Por, në mënyrë shumë telegrafike, të dhënat statistikore për vitin 2024 për veprimtarinë e ILD janë:

Gjatë vitit 2024, ILD kishte 2854 ankesa për trajtim. Nga këto ka trajtuar 1374 ankesa. 54 prej tyre kanë përfunduar me hetim disiplinor. Gjatë vitit 2024 ka një dyfishim të kërkesave

për procedim disiplinor, konkretisht janë 11 magistratë të proceduar, 6 gjyqtarë dhe 5 prokurorë, me masa që variojnë nga shkarkimi nga detyra, deri tek vërejtja konfidenciale. Veç ankesave dhe procedimeve disiplinore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kryer edhe 6 inspektime tematike, të cilat kanë përfunduar me 54 rekomandime, prej të cilave, 9 lidhen me marrjen e masave për nxjerrje aktesh, 29 me ndërmarrjen e masave administrative dhe 15 rekomandime për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për procedura të mëtejshme verifikuese. Për të gjitha vendimmarrjet e trajtimit të ankesave nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë vitit që shkoi, ka pasur vetëm 89 ankime pranë KLP ose KLGJ, sipas rastit. Asnjë prej vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk është cenuar.

Megjithatë, përtej shifrave, të cilat tregojnë dinamikë dhe funksionalitet të mekanizmit llogaridhënës të gjyqtarëve dhe prokurorëve, unë vlerësoj se është e domosdoshme, që Inspektori i Lartë i Drejtësisë të vijë përpara jush, edhe me një panoramë të gjendjes së sistemit të drejtësisë, natyrisht sipas këndvështrimit të ILD, për të prezantuar para jush sfidat me të cilat përballët sistemi dhe çështjet që duhet të adresojmë ne, organet e sistemit të drejtësisë, por edhe të tjerë aktorë institucionalë dhe publikë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, bazon punën e tij *së pari*, te ankesat që i paraqiten nga qytetarë apo nga institucione të ndryshme, *së dyti*, në inspektimet tematike, që ai kryen dhe këtu duhet evidentuar që numri i inspektimeve është rritur cdo vit, *së treti* nëpërmjet mekanizmave të tjerë administrativë, që ka ngritur ILD, për të marrë informacion për punën e gjykatave dhe prokurorive, tej atyre që paraqesin ankesat apo inspektimet tematike. Bazuar në këto drejtime është përgatitur edhe panorama, që dëshiroj të paraqes përpara jush, për çështjet me të cilat përballët sistemi sot, me mënyrën si i ka adresuar ILD këto çështje dhe sfida të tjera, të cilat duhen adresuar nga organet e drejtësisë dhe nga aktorë të tjerë institucionalë dhe publikë.

Nga veprimtaria e vet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka evidentuar disa problematika dhe konkluzione, si më poshtë:

1. ***Kohëzgjatja e gjykimeve tej afateve të arsyeshme zvarritja e veprimeve hetimore dhe vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore***

Efektiviteti dhe standardi i sistemit të drejtësisë nuk është në nivelin e duhur dhe të kënaqshëm për qytetarët shqiptarë. Për sa vërehet, problematike vijon të

mbetet tejzgjatja e proceseve gjyqësore, një problem i evidentuar në mënyrë të vazhdueshme nga ankesat, jurisprudenca e GJEDNj, por dhe në raportet e organizmave ndërkombëtare. Në vendimmarrjen e saj të fundit, GJEDNj ka adresuar edhe rekomandime konkrete për autoritetet vendase, duke theksuar nevojën e plotësimit të vakancave në Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. **Tejzgjatja e proceseve gjyqësore** ndikon drejtpërdrejtë në perceptimin dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, rritja e besimit të të cilit është një nga shkaqet kryesore, për të cilën u ideua dhe u ndërmor reforma në drejtësi.

Nëpërmjet instrumenteve ligjore në dispozicion, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka adresuar këtë problematikë, nëpërmjet rekomandimeve të natyrës rregullatore dhe administrative, që kanë rezultuar nga inspektimi tematik i kryer pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore, gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023, inspektim tashmë i konkluduar me rekomandime konkrete për aktorët e sistemit të drejtësisë.

Nga ky inspektim tematik rezultoi se:

a) ***Arsyeja e parë*** që ka ndikuar në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore tej afateve të arsyeshme është ngarkesa e magjistratëve të kësaj gjykate. Për vitin 2023, ngarkesa mesatare e punës për një gjyqtar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka qenë mesatarisht 1176 çështje për gjykim, ndërkohë që për gjyqtarët pranë gjykatave të të njëjtit nivel gjyqësor ka qenë 841.7



çështje për gjyqtar.

Për vitin 2023, numri i gjyqtarëve në organikën e miratuar të kësaj gjykate është 80 gjyqtarë, ndërkohë që efektivisht kanë ushtruar detyrën gjatë vitit 2023, vetëm 43 gjyqtarë.

b) *Arsyeja e dytë* janë vakancat e paplotësuara pranë kësaj gjykate. Nga ky inspektim rezultoi se organika e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Penale dhe Civile) për vitin 2023, rezulton e plotësuar në masën 54%, sa i takon kësaj trupe. Duke vlerësuar rëndësinë që ka plotësimi i vakancave në sistem, nisur nga raportet e Komisionit Evropian dhe Raportit të vitit 2025 për Shtetin e së Drejtës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka rekomanduar Këshillit të Lartë Gjyqësor, si institucioni përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata, marrjen e masave efektive dhe të

menjëhershme për plotësimin e organikës e kësaj gjykate, duke vendosur edhe një afat 1 vjeçar për përmbushjen e tij. Nga ana jonë do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmbushja e këtij rekomandimi, brenda fushës së kompetencave që ILD ushtron.

c) *Arsyeja e tretë* është infrastruktura, por këtë çështje do ndalem pak më poshtë.

Nga ana tjetër, në të gjitha ato raste ku ILD, në kuadër të verifikimit dhe hetimit disiplinor ka konstatuar se vonesat apo zvarritjet kanë tejkaluar çdo afat të arsyeshëm, duke demonstruar neglizhencë të magjistratit në përmbushje të detyrës, për shkaqe të palidhura me arsye jashtë kontrollit të magjistratit, ka paraqitur kërkesat për procedimin disiplinor pranë Këshillave përkatës. Në total, gjatë veprimtarisë së vet, në rastet e vonesave dhe zvarritjeve në gjykim apo procedim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor për 51

magjistratë dhe në përfundim të tyre janë paraqitur kërkesat për procedim disiplinor për 17 magjistratë, 8 gjyqtarë dhe 9 prokurorë. Masat e propozuar për këto shkelje disiplinore janë:

- “Shkarkim nga detyra”, për 2 gjyqtarë dhe 3 prokurorë;
- “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 përqind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit”, për 3 gjyqtarë dhe 5 prokurorë;
- “Vërejtje publike”, për 3 gjyqtarë dhe 1 prokuror.

Një inspektim tjetër i zhvilluar nga ILD është edhe përdorimi i mekanizmave alternativë të gjykimit. Ky inspektim është zhvilluar pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, Tiranë, Durrës dhe Vlorë dhe nga inspektimi është konstatuar, se ndërmjetësimi është përdorur në mënyrë shumë të kufizuar, pavarësisht detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 25 të Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim të këtyre inspektimeve është rekomanduar ndër të tjera, pasqyrimi i çdo orientimi të gjyqtarit për ndërmjetësim në procesverbalet e seancave gjyqësore, në mënyrë që të mundësohet monitorimi dhe analizimi i kësaj praktike në inspektimet pasardhëse.

Për të monitoruar veprimtarinë e prokurorëve, në kuadër të ankesave të vazhdueshme për zvarritje të veprimtarisë hetimore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka iniciuar inspektimin tematik të çështjeve, për të cilat prokurori ka proceduar me kërkesë ose vendimmarrje për pushim, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale përgjatë vitit 2024. Nëpërmjet këtij inspektimi dhe inspektimit institucional, që po zhvillohet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë, mbi të gjithë procesin e qarkullimit të dokumentacionit në këtë zyrë prokurorie, In-

spektori i Lartë i Drejtësisë synon jo vetëm të evidentojë problematikat, por dhe të adresojë çështje të aspektit sistematik.

Arsyetimi me vonesë i vendimeve gjyqësore përbën një tjetër problem sistematik me impakt në të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor. Inspektori i Lartë i Drejtësisë duke reflektuar dhe rekomandimet e lëna për veprimtarinë e këtij institucioni gjatë vitit 2023 në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, ka vendosur kryerjen e inspektimeve tematike në disa gjykata të juridiksionit të përgjithshëm dhe në një gjykatë të juridiksionit administrativ. Nëpërmjet këtyre inspektimeve tematike, ILD ka bërë një fotografim të situatës së dorëzimit të vendimeve gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Shkodër dhe aktualisht është në përmbyllje të inspektimit tematik pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë. Në përfundim të çdo inspektimi, ILD ka vlerësuar të identifikojë një periudhë kohe të arsyeshme, që i nevojitet magjistratit për dorëzimin e vendimit përfundimtar të arsyetuar, duke marrë në konsideratë mesataren e kohës, që i nevojitet çdo magjistrati në të njëjtën gjykatë për arsyetimin e vendimeve lidhur me çështje të të njëjtës tipologji. Afati i vlerësuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përfundim të çdo inspektimi, nuk zëvendëson në asnjë rast afatin ligjor, por përbën një konstatim nga ILD në momentin e kryerjes së inspektimit, duke mbajtur në konsideratë situatën aktuale të ngarkesës që ka sistemi sot dhe vakancat në sistemin e drejtësisë. Në këtë kuadër, personalisht mendoj se angazhimi i gjykatës, KLGJ-së, apo dhe vetë Kuvendit, për të hartuar dhe miratuar masa me qëllim reduktimin e backlogut, i

cili ka arritur në një numër të madh është një mjet i domosdoshëm.

2. *Infrastruktura e gjykatave dhe regjistrimi i seancave audio*

Një tjetër problematikë me të cilën po ballafaqohen gjykatat sot është **mënyra e zhvillimit të seancave gjyqësore në kushtet e mungesës së infrastrukturës së nevojshme për respektimin e kërkesave procedurale për zhvillimin e gjykimit me regjistrim audio**. Nga përmbajtja e ankesave, verifikimeve dhe informacionet periodike që administrohen në ILD ka rezultuar, se infrastruktura aktuale nuk mundëson zhvillimin e të gjithë seancave gjyqësore sipas detyrimit ligjor me regjistrim audio, kjo në veçanti në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Këto mangësi së bashku me vakancat në sistem, kanë ndikuar në cilësinë e kushteve të punës, duke ekspozuar trupën gjyqësore në mungesë të solemnitetit të zhvillimit të proceseve gjyqësore.

Gjatë realizimit të inspektimit në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore është evidentuar kjo problematikë dhe ILD ka rekomanduar, që Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Kryetarin e Gjykatës dhe Këshillin e Gjykatës, të marrin masat e nevojshme për të garantuar shfrytëzimin e ambienteve të gjykatës, në mënyrë që gjykimi i të gjitha çështjeve civile me palë kundërshtare të zhvillohet në salla gjykimi të pajisura me regjistrim audio, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2026.

3. *Respektimi i solemnitetit të gjykimit dhe i standardeve etike*

Respektimi i rregullave të etikës dhe solemnitetit është në fokus të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sjellja e magjistratit

është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Në çdo procedim disiplinor të iniciuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përpjekur të ruajë balancën, ndërmjet mungesave dhe sfidave, me të cilat po përballen magjistratët në punën e tyre, me detyrën që magjistrati ka për të shfaqur një model sjellje, i cili mbart vlera, të cilat jo vetëm duhet të transmetohen, por edhe të shfaqen, gjatë ushtrimit dhe jashtë ushtrimit të funksionit. Në rastet kur sjellja jo-etike është faktuar gjatë kryerjes së hetimit disiplinor janë përcjellë propozimet për marrjen e masave disiplinore nga Këshillat. Gjatë veprimtarisë së vet, ILD ka vendosur hetimin disiplinor për 14 magjistratë, 10 gjyqtarë dhe 4 prokurorë për cenim të rregullave të etikës dhe në përfundim të tyre janë paraqitur kërkesat për procedim për 7 magjistratë, 3 gjyqtarë dhe 4 prokurorë duke propozuar:

- “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit” për 2 magjistratë.
- “Vërejtje publike” për 3 magjistratë.
- “Vërejtje konfidenciale” për 2 magjistratë.

Masa ndëshkuese siç është evidentuar në mënyrë të vazhdueshme është mjeti i fundit, që duhet të zbatohet për të garantuar përgjegjshmërinë e sistemit. Për këtë arsye, vlerësoj se nga Këshillat përkatëse duhet të kenë një bashkëpunim më të ngushtë me Shkollën e Magjistraturës në trajnimin vazhdues të magjistratëve, veçanërisht atyre me më pak vite përvojë në sistem, në kuadër të shpeshimit të trajnimeve dhe individualizimit të tyre për rastet e referuar nga ILD dhe rastet për të cilat është vendosur marrja e masave disiplinore. Njëkohësisht vëmendje duhet t’i kushtohet edhe trajnimit vazhdues të magjistratëve të tjerë, në përgatitjen e tematikave me efekt ndërgjegjësuës dhe parandalues për shmangien e sjelljeve të tilla

në të ardhmen, të cilat mund të kenë impakt serioz në perceptimin e publikut për sistemin e drejtësisë.

4. ***Qëndrimet në lidhje me vendimmarrjet gjyqësore dhe roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në raport me këtë problematikë***

ILD vlerëson të ritheksojë, se roli i tij në shqyrtimin e pretendimeve për vendimmarrje të padrejta nga aktorët e sistemit të drejtësisë, nuk mund të zëvendësojë interpretimin dhe zbatimin, që prokurori i bën normave dhe instituteve procedurale penale, apo dhe shqyrtimin e pavarur gjyqësor që bën gjykata. Kjo është kompetencë e organeve të sistemit të drejtësisë, e cila kontrollohet në themel nga organizimi hierarkik i vetë gjyqësorit, nëpërmjet mekanizmave procedurale të parashikuara nga ligji.

Elementi i përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, sipas qëndrimeve tashmë të ven-

dosura edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, del në pah kur magjistrati gjatë vendimmarrjeve të tij vepron në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin, të evidentuara këto prej vendimeve të gjykatave më të larta, apo në kundërshtim me praktikën unifikuese të gjykatave më të larta duke deformuar bindjen e brendshme, e cila duhet të jetë në përputhje me ligjin, analizën e fakteve dhe provave. Edhe cenimi i vendimmarrjes brenda shkallëve të gjyqësorit është pjesë kontrollit të vendimeve gjyqësore dhe ushtrimit të hierarkik të pushtetit gjyqësor. Ky kontroll gjyqësor realizohet në kuadër të rritjes së cilësisë së drejtësisë dhe nuk ka si qëllim në vetvete, përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve. Ndryshimi apo prishja e një vendimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë, nuk mund të përbëjë *apriori* bazë të mjaftueshme faktike për procedimin disiplinor të magjistratit, nëse nuk shoqërohet me elementë të tjerë, të cilat tregojnë se magjistrati ka vepruar në keqbesim, duke çeduar nga detyrimi për ushtrimin



me dinjitet të detyrës, në përputhje me ndërgjegjen për interpretimin e fakteve, në zbatim të normave të së drejtës.

Në këtë kuptim, në rastet kur janë evidentuar shkaqet si më sipër, të cilat kanë sjellë diskreditim të pozitës dhe figurës së magjistratit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka iniciuar 25 hetime disiplinore dhe ka paraqitur kërkesat për procedim për 9 magjistratë, 7 gjyqtarë dhe 2 prokurorë duke kërkuar:

- Shkarkim nga detyra, për 3 magjistratë;
- Pezullim nga detyra për 1 magjistrat;
- Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit, për 4 magjistratë;
- Vërejtje publike për një magjistrat.

Një moment tjetër, që duhet evidentuar në kompetencat dhe rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është dallimi i qartë, ndërmjet procedurës disiplinore dhe asaj penale. Kushtetuta dhe ligji i kanë dhënë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë attribute të qarta në kryerjen e procedurave të hetimit disiplinor ndaj magjistratëve, apo subjekteve të tjera të përfshira në fushën e kompetencës së këtij institucioni. Hetimi dhe procedura disiplinore nuk kanë natyrë penale, nuk kane mjete kërkimi si një organ i ndjekjes penale, por është proces administrativ. Rregullat dhe procedurat që ligji ka parashikuar, i shërbejnë garantimit të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor ndaj magjistratit, që dyshohet se ka kryer shkeljen disiplinore dhe palëve të tjera pjesëmarrëse në këtë proces dhe nuk ofrojnë mekanizma për të evidentuar ekzistencën e një fakti penal. Jo pa arsye, legjislatori i kanë përparësi procedurave penale, civile apo administrative duke e detyruar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të përzullosë hetimin disiplinor, kur është duke

u zhvilluar një hetim penal ndaj magjistratit për të njëjtat fakte.

5. *Problematika në lidhje me organizimin dhe funksionimin e zyrave të prokurorive*

Në funksion të bashkëpunimit ndërinstitucional me Prokurorinë e Përgjithshme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka mbajtur kontakte të vijueshme me këtë institucion dhe për këtë qëllim ka lidhur edhe një marrëveshje bashkëpunimi. Ankesat e referuara nga Prokurori i Përgjithshëm kanë shërbyer si të dhëna për inicimin e verifikimeve dhe hetimeve disiplinore ndaj disa magjistratëve, të cilat janë konkluduar me propozimin e masave disiplinore, përfshirë dhe shkarkimin nga detyra.

Njëkohësisht, **veprimtaria e zyrave të prokurorisë, në drejtim të zbatimit të akteve rregullatore në marrëdhënie me drejtuesin** ka qenë objekt inspektimi tematik. Ky inspektim ka patur qëllim **zbatimin e urdhrave të Prokurorit të Përgjithshëm**, mbi ruajtjen e qëndrueshmërisë së organit të prokurorisë, përmes kohezionit institucional dhe uniformitetit të veprimtarisë në të gjitha prokuroritë, në garantimin e pavarësisë funksionale të prokurorit në vendimmarrje për çështje konkrete. Ky inspektim vlerësohet të vijohet edhe në vazhdim, pasi **nga monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna**, por edhe nga verifikimet e kryera në kuadër të procesit të shqyrtimit të ankesave **janë konstatuar përsëri problematika**.

Në përmbushje të detyrimit ligjor për inspektimin e ndarjes së çështjeve me short në zyrat e prokurorive, ILD ka rekomanduar rishikim të aktit rregullator “Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori” dhe unifikim të praktikave të ndryshme të evidentuara gjatë kryerjes së inspektimit, në zyrat e pro-

kurorive pranë Gjykatave të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ky inspektim referuar detyrimeve ligjore do të vijohet, duke patur në fokus monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

6. **Produktiviteti në zhvillimin e seancave**

Marrë shkas nga disa ankesa, të cilat i janë nënshtruar verifikimit, por edhe informacionit të paraqitur nga vetë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, një problematikë e sistemit gjyqësor sot është produktiviteti dhe efektiviteti i magjistratëve në planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore, si dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Për adresimin e kësaj situate, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur kryerjen e një inspektimi tematik në disa gjykata të juridiksionit të përgjithshëm, me qëllim inspektimin e mënyrës së planifikimit të seancave gjyqësore dhe menaxhimit e shqyrtimit të çështjeve sipas kategorive përkatëse, në përputhje me afatet e vendosura nga dispozitat procedurale. Një faktor që ndikon në normën e pamjaftueshme të evadimit të çështjeve gjyqësore, siç e kemi evidentuar edhe në raportet tona të inspektimit tematik është **mosplotësimi i vakancave në gjykatat e shkallës së parë dhe në veçanti në Gjykatën e Apelit të Ju-**

ridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit. Ky proces, siç evidentohet është i lidhur me mospërfundimin në kohë të procedurave të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve. Në këtë kuadër, vlerësojmë të nevojshme marrjen e masave konkrete për të rritur efektivitetin e këtij procesi, duke orientuar dhe bashkëpunimin e Këshillave në aplikimin e standardeve uniforme të vlerësimit, nën dritën edhe të orientimeve të dhëna nga vendim-marrja e Gjykatës së Lartë.

Të nderuar deputetë!

Pavarësisht rezultateve të deritanishme, institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konstaton, se sistemi i drejtësisë përballët me sfida të rëndësishme, që lidhen me organizimin dhe funksionimin e tij. **Efektiviteti dhe cilësia e sistemit të drejtësisë nuk janë në nivelin, që i përgjigjet pritshmërive të qytetarëve shqiptarë.** Kjo është pjesë e procesit të konsolidimit të Reformës në Drejtësi dhe një përgjegjësi e të gjithë organeve tona, duke filluar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, organet e qeverisjes së pushtetit gjyqësor, apo magjistratët gjyqtarë dhe prokurorë.

Një aspekt që kërkon vëmendje të veçantë

Pavarësisht rezultateve të deritanishme, institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konstaton, se sistemi i drejtësisë përballët me sfida të rëndësishme, që lidhen me organizimin dhe funksionimin e tij. Efektiviteti dhe cilësia e sistemit të drejtësisë nuk janë në nivelin, që i përgjigjet pritshmërive të qytetarëve shqiptarë. Kjo është pjesë e procesit të konsolidimit të Reformës në Drejtësi dhe një përgjegjësi e të gjithë organeve tona.

është **infrastruktura e pushtetit gjyqësor**. Mungesa e ambienteve të përshtatshme dhe aplikimi i teknologjisë së informacionit, përfshirë sistemet e regjistrimit audio të seancave, sistemet e menaxhimit të çështjeve, arkiva, qarkullimi i dokumentacionit procedural dhe administrativ, apo sisteme teknologjike që mbulojnë procese të veçanta të punës së gjykatës apo prokurorisë, ndikojnë drejtpërdrejt, në cilësinë dhe solemnitetin e gjykimit apo zhvillimit të procesit të hetimit penal. Në disa raste, **këto kushte kanë ndikuar edhe në sjelljen etiko-profesionale të magjistratëve, duke ekspozuar sistemin e drejtësisë ndaj perceptimeve negative nga publiku**. Për këtë arsye, investimi në infrastrukturë duhet të shihet si pjesë e pandarë e politikave për forcimin e pavarësisë, legjitimitetit dhe integritetit të pushtetit gjyqësor.

Ngarkesa e jashtëzakonshme e punës dhe numri i lartë i çështjeve gjyqësore, mbetet një ndër sfidat më serioze, që cenon cilësinë dhe kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, si dhe të drejtat e shtetasve shqiptar në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Në këtë drejtim, kërkohet angazhimi i përbashkët i të gjithë organeve publike, si Kuvendi, Këshillat, Prokurori i Përgjithshëm, gjykata apo dhe zyrat e prokurorive për hartimin e masave konkrete për reduktimin e backlogut; rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, plotësimin e organikave, shtimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e infrastrukturës. Njëkohësisht, vetë gjykatat dhe zyrat e prokurorisë duhet të hartojnë sisteme të prioritizimit të çështjeve, për të siguruar një trajtim më të shpejtë dhe të drejtë të dosjeve gjyqësore.

Sistemi llogaridhënës përbën gurin e themelit për një shtet të së drejtës. Vetëm nëse ky sistem funksionon në mënyrë të plotë, të drejtë dhe efektive, pushteti

gjyqësor mund të organizohet mbi baza të qëndrueshme profesionalizmi, integriteti dhe legjitimiteti. Në të kundërt, **një sistem përgjegjësie që funksionon vetëm në aspektin ndëshkues e jo parandalues, humbet rolin e tij edukues dhe kontribuon në uljen e besimit publik**. Llogaridhënia e pushtetit gjyqësor duhet të perceptohet si një mekanizëm parandalues dhe përmirësimi, jo si mekanizëm intimidimi, ndërhyrje apo ndëshkimi.

Roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet të shihet thjesht në aspektin disiplinor, por në një prizëm më të gjerë edukues dhe parandalues. Qëllimi është të krijohet një kulturë e lartë etike dhe profesionale në sistemin e drejtësisë, ku ndjenja e llogaridhënies të jetë pjesë e vetëdijes së magjistratëve dhe jo një faktor i jashtëm. Nëse sistemi i përgjegjshmërisë, pra shkollimi në Shkollën e Magjistraturës, emërimet dhe promovimet e magjistratëve nga Këshillat, roli i gjykatave më të larta për rritjen e cilësisë së vendimeve gjyqësore, etj., funksionon në mënyrë të plotë, të drejtë dhe efektive, atëherë pushteti gjyqësor do të organizohet dhe do të funksionojë mbi baza të qëndrueshme profesionalizmi, legjitimiteti dhe të integritetit. Në rast të kundërt, nëse ky sistem nuk funksionon, aplikimi i sistemit të përgjegjësive së magjistratëve (*pra, sanksionet*) mund të jetë një mekanizëm dhe reagim i vonuar, duke mos luajtur një rol parandalues, por vetëm ndëshkues, si dhe duke sjellë si pasojë, jo vetëm cenimin e besimit të publikut në pushtetin gjyqësor, por edhe legjitimitetin apo autoritetin e këtij pushteti.

Ky është dimension i vërtetë dhe filozofia e një reforme legjitime në një sistem drejtësie: **ndërtimi i një sistemi drejtësie, që vetërregullohet përmes integritetit të tij**. Ky diskutim na çon drejt një dileme universale,

Sfida më e madhe e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sot është ruajtja e pavarësisë së tij institucionale dhe sigurimi i një roli konstruktiv në garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Jo si një lojë fjalësh dhe jo si mburojë për paligjshmëritë eventuale, që mund të kryejë sistemi. Por, si një parim i rëndësishëm për të ardhmen e vendit, si një parim që tregon se sistemi llogaridhënës ndaj magjistratëve nuk është zgjedhje apo emocion, aq më pak i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

që hasin shumë shtete: balancimi midis pavarësisë dhe llogaridhënies. Edhe në Shqipëri, ku sistemi i drejtësisë është ende në fazë konsolidimi pas reformimit të thellë institucional, ky ekuilibër kërkon kujdes të veçantë. Nga njëra anë, duhet të mbrohet pavarësia funksionale e magjistratit, si themel i shtetit të së drejtës, ndërsa nga ana tjetër, duhet të garantohet, që kjo pavarësi të mos shndërrohet në mungesë përgjegjësie.

Sfida më e madhe e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sot është ruajtja e pavarësisë së tij institucionale dhe sigurimi i një roli konstruktiv në garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Jo si një lojë fjalësh dhe jo si mburojë për paligjshmëritë eventuale, që mund të kryejë sistemi. Por, si një parim i rëndësishëm për të ardhmen e vendit, si një parim që tregon se sistemi llogaridhënës ndaj magjistratëve nuk është zgjedhje apo emocion, aq më pak i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Por është parim mbi të cilin bazohet një shtet ligjor. **Në këtë kontekst, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të dëshmojë integritet, transparencë dhe paanshmëri, në çdo vendimarrje.** Ky është një proces i ndjeshëm, ku institucioni duhet të veprojë si mbrojtës i parimeve të drejtësisë, por jo si faktor që ndikon, apo orienton vendimarrjen e pushtetit gjyqësor.

Në këtë proces, Inspektori i Lartë i Drejtësisë do të vijojë të zbatojë me përkushtim, standartet më të larta të procesit të rregullt ligjor, si dhe të jetë garant i ekuilibrit midis pavarësisë dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor shqiptar.

Sot po përballemi me një paqartësi mbi rolin dhe funksionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që nuk rrjedh vetëm nga qytetarët, të cilët nëpërmjet ankesave të paraqitura në ILD pretendojnë zgjidhje të mosmarrëveshjeve gjyqësore, ndërhyrje në procese gjyqësore, apo ndikim në vendimarrje gjyqësore, por haset edhe në kuadër të pretendimeve të shumta nga rrethe të tjera publike, ku përfshihen aktorët politikë, media apo dhe vetë organet të tjera publike.

Ky fenomen kërkon një adresim në aspektin sistematik. Një rëndësi thelbësore në garantimin e një sistemi cilësor drejtësie ka edhe Gjykata e Lartë, si organi më i lartë në piramidën e hierarkisë gjyqësore, jo vetëm nëpërmjet zgjidhjes së konflikteve, por dhe në sigurimin e shmangies së divergjencave dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë në interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Për këtë arsye, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kërkuar një vëmendje të veçantë nga ana e Gjykatës së Lartë, për të ushtruar rolin e saj njehsues, në vendosjen e standardeve dhe praktikave të

qëndrueshme.

Njëkohësisht, besoj se procesi i edukimit ligjor të publikut, përbën një parakusht të domosdoshëm për konsolidimin e besimit në drejtësi. Një publik i informuar, i ndërgjegjshëm dhe aktiv është partneri më i vlefshëm i institucioneve të drejtësisë. Këtu një rol thelbësor duhet të luajë edhe Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut.

Nëse qytetarët nuk e kuptojnë rolin e institucioneve të drejtësisë, magistratëve, kufijtë e kompetencave të institucioneve dhe mekanizmat e ankimit, sistemi i drejtësisë rrezikon të perceptohet si i mbyllur dhe i pakuptueshëm. Sot po përballemi më një situatë shqetësuese, ku faktorët, të cilët kanë ndikuar në krijimin e saj mund të jenë të ndryshëm. Por mungesa e reagimit dhe marrjes së masave nga ana jonë për të parandaluar këto fenomene negative mund të sjellë pasoja të rënda, jo vetëm për sistemin e drejtësisë, por edhe për vetë shoqërinë tonë. Për këtë arsye, personalisht mendoj se të gjitha organet tona duhet të vijnë më tej përpjekjet dhe të investojnë në transparencë, edukim ligjor dhe komunikim publik, duke e bërë drejtësinë më të afërt me qytetarin, më të qartë në funksionet e saj dhe më të

besueshme në rezultatet që prodhon, apo që ka detyrim ligjor të prodhojë.

Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ofron angazhim maksimal, që të zhvillojë një kulturë bashkëpunimi dhe koordinimi institucional, ku të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë si KLGJ, KLP, Gjykata e Lartë, Shkollat e Magjistraturës, apo dhe organet e tjera, si Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, të punojnë mbi plane veprimi strategjik të përbashkëta, për përmirësimin e cilësisë së drejtësisë dhe forcimin e besimit të qytetarëve.

Ky proces kërkon vizion afatgjatë, plan të strukturuar zbatimi dhe një vlerësim të vazhdueshëm të rezultateve, në mënyrë që çdo rekomandim të shndërrohet në realitet institucional. Rruga drejt një sistemi drejtësie efikas dhe të qëndrueshëm kërkon bashkërendim institucional, transparencë dhe respekt të parimit të ndarjes së pushteteve. Vetëm në këtë mënyrë, drejtësia shqiptare do të mund të funksionojë mbi themele të qëndrueshme profesionalizmi, integriteti dhe besueshmërie.

Ju faleminderit!

Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ofron angazhim maksimal, që të zhvillojë një kulturë bashkëpunimi dhe koordinimi institucional, ku të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë si KLGJ, KLP, Gjykata e Lartë, Shkollat e Magjistraturës, apo dhe organet e tjera, si Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, të punojnë mbi plane veprimi strategjik të përbashkëta, për përmirësimin e cilësisë së drejtësisë dhe forcimin e besimit të qytetarëve.



SESIONI PYETJE-PËRGJIGJEVE I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË Z. ARTUR METANI ME DEPUTETËT NË SEANCË PLENARE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Pyetjet e deputetit Eno Bozdo.

Pyetja 1. Pyetja e parë e zotit Bozdo është një grup pyetjesh. Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 96/2016, (nenet 124, 124/1) Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka të drejtë të fillojë hetimin disiplinor kryesisht, kur informacioni nga media apo burime të tjera është i besueshëm. Në ushtrim të së drejtës së tij për të filluar kryesisht procedimin disiplinor, ILD ka të drejtë të kërkojë nga çdo institucion të dhëna në lidhje me pasurinë apo figurën e magjistratit. A është indicie e besueshme një vendim gjyqësor penal i autoritetit gjyqësor të huaj i marrë në formën e kërkuar nga ligji, me apostile për ILD për të filluar një procedim disiplinor ndaj një magjistrati në detyrë në Gjykatën e Posaçme?

A është indicie e besueshme informacioni i Prokurorisë së Përgjithshme se vendimi i dënimit penal të magjistrates Irena Gjoka është autentik? Pse nuk është i mjaftueshëm ky informacion për marrjen e të dhënave kryesisht nga ILD, administrimin e praktikës dokumentare nga Prokuroria e Përgjithshme, kërkimi i informacionit nga Shërbimet Shtetërore Informative, apo institucione të tjera që kanë informacion?

A është informacion i mjaftueshëm për të kërkuar informacion në lidhje me deklaratat apo formularët e plotësuar nga magjistratja Irena Gjoka për efekte të kalimit/emërimit të saj në Gjykatën e Posaçme, apo gjatë procedurës së procesit të vlerësimit kalimtar, duke qenë se sipas nenit 102 të ligjit nr. 96/2016 çdo magjistrat ka detyrimin e deklarimit të shkaqeve për mbarimin e mandatit, në të kundërt kryen shkel-

je disiplinore, si dhe mosdeklarimi i çdo vendimi dënimi përbën shkak shkarkimi për gjyqtaret e gjykatave të posaçme?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Për pyetjen e parë, fakti që pretendohet në 3 pyetjet e mësipërme ka natyrë penale, siç edhe u evidentua nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky fakt është në hetim dhe vetëm në përfundim të hetimit penal, Inspektori i Lartë i Drejtësisë do të vlerësojë mbi përgjegjësi disiplinore administrative të magistrates Gjoka. Ligji për “Statusin”, i cili disiplinon procedurën e hetimit disiplinor që kryhet nga ILD në nenin 126 të tij i jep përparësi procesi penal, në krahasim me një procedurë disiplinore, që mund të zhvillohet për të njëjtat fakte. Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përfundim të procesit penal do të vlerësojë nëse ka fakte të mjaftueshme për të filluar një procedurë disiplinore sipas parashikimeve ligjore.

Pyetja 2. Edhe për këtë pyetje, është një grup pyetjesh. Bazuar në nenin 102 nr. 96/2016 është parashikuar si shkelje disiplinore në ushtrim të detyrës, ndër të tjera mosrespektimi i legjislacionit procedural, kur një fakt i tillë është konstatuar nga gjykatat më të larta.

A është indicie e mjaftueshme për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për fillimin kryesisht të procedimit disiplinor konstatimi i zbatimit të gabuar të legjislacionit procedural penal nga GJEDNJ?

A ka shërbyer rasti “Gëllçi” kundër Shqipërisë për ILD për të verifikuar nëse ka shkelje disiplinore nga magistratët që caktuan apo miratuan masat e sigurimit përkatës?

A është indicie e mjaftueshme për ILD për fillimin e procedimit disiplinor kryesisht konstatimi i GJEDNJ se Gjykata e Lartë ka një praktikë të gabuar në rrëzimin e kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjyqimit, se reforma në drejtësi nuk është shkak i

mjaftueshëm për të përligjur vonesat në gjykim?

A është indicie e mjaftueshme për ILD konstatimi nga Gjykata Kushtetuese se vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar?

A ka ILD një praktikë, sa vendime duhet të konstatohen në shkelje të Kushtetutës për një magistrat, që ndaj tij të fillojë procedimi disiplinor?

A është i mjaftueshëm për ILD për të filluar hetim disiplinor ndaj prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe gjyqtarëve që kanë miratuar kërkesat e tyre konstatimi nga Gjykata Kushtetuese se janë shkelur të drejtat kushtetuese të individëve, në një rast edhe gazetar, me anë të kontrolleve të pajustificuara, të paarsyetuara, me interpretimin, jo në pajtim me Kushtetutën dhe KEDNJ të dispozitave në lidhje me sekuestrimin e korrespondencës?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Cënimi i vendimmarrjes brenda shkallëve të gjyqësorit është pjesë e kontrollit të vendimeve gjyqësore dhe ushtrimit hierarkik të pushtetit gjyqësor. Ky kontroll gjyqësor realizohet në kuadër të rritjes së cilësisë së drejtësisë dhe nuk ka si qëllim në vetvete përgjegjësinë disiplinore të magistratëve. Ndryshimi apo prishja e një vendimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë, nuk mund të përbëjë apriori, bazë të mjaftueshme faktike për procedimin disiplinor të magistratit, nëse nuk shoqërohet me elementë të tjerë, të cilat tregojnë se magistrati ka vepruar në keqbesim duke ceduar nga detyrimi për ushtrimin me dinjitet të detyrës në përputhje me ndërgjegjen për interpretimin e fakteve në zbatim të normave të së drejtës.

Nëpërmjet instrumenteve ligjorë në dispozicion, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka adresuar problematikën e tejzgjatjes së proceseve gjyqësore

tej afateve të arsyeshme, nëpërmjet rekomandimeve të natyrës rregullatore dhe administrative, që kanë rezultuar nga inspektimi tematik të kryera. Në rastet kur ka evidentuar shkelje disiplinore, raste të vonesave dhe zvarritjeve në gjykim apo procedim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor për 51 magjistratë dhe në përfundim të tyre janë paraqitur kërkesat për procedim disiplinor për 17 magjistratë, 8 gjyqtarë dhe 9 prokurorë. Masat e propozuara për këto shkelje disiplinore janë:

- “Shkarkim nga detyra” – për 2 gjyqtarë dhe 3 prokurorë;
- “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 përqind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit”- për 3 gjyqtarë dhe 5 prokurorë;
- “Vërejtje publike” – për 3 gjyqtarë dhe 1 prokuror.

Procedimi disiplinor nuk lidhet me numrin e vendimeve që mund të konsiderohen si në shkelje të Kushtetutës. Inspektori i Lartë i Drejtësisë vendos hetimin disiplinor kur ekzistojnë fakte të mjaftueshme që krijojnë standardin e dyshimit të arsyeshëm se shkelja disiplinore është kryer.

Sa i takon cenimit të vendimmarrjeve të Gjykatës së Lartë nga Gjykata Kushtetuese për mangësi në arsyetim, sqaroj se ky cenim është në kuadër të kontrollit kushtetues që Gjykata Kushtetuese realizon në funksion të respektimit të parimit të procesit të rregullt ligjor. Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka evidentuar asnjë rast, ku vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me mungesën e arsyetimit të përbëjë shkak për fillimin e një hetimi disiplinor. Pavarësisht kësaj ne monitojmë në mënyrë të vazhdueshme respektimin nga organet e pushtetit gjyqësor të standardeve të vendosura nga Gjykata Kushtetuese.

Nga verifikimet e kryera nuk ka rezultuar që vendimmarrjet e gjykatave të posaçme të jenë cënuar nga Gjykata e Lartë, me arsyetimin se janë dhënë në kundërshtim të hapur dhe flagrant

me ligjin, apo praktikat unifikuese të Gjykatës së Lartë të tilla, që të kenë sjellë diskreditim të pozitës dhe figurës së magjistratit për të justifikuar fillimin e një hetimi disiplinor.

Pyetjet 3, 4 dhe 5. *A mjafton njoftimi publik se është arrestuar një avokat për shkak të ushtrimit të detyrës në sallën e gjyqit, për të filluar procedimin disiplinor kryesisht nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për magjistratët e përfshirë?*

A është e mjaftueshme sjellja e magjistratit prokuror, që vendos të nxjerrë jashtë sallës së gjyimit palën kundërshtare, vendos ta arrestojë dhe më tej e arreston, për të filluar procedimin disiplinor ndaj tij? A duhet të kishte një reagim më reaktiv nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për rastin?

A është e mjaftueshme për të filluar hetimin disiplinor ndaj magjistrates gjyqtare për njëanshmëri në gjykim, pasi ka lejuar që seancën ta drejtonte prokurori, ka penguar aktivisht të drejtën e mbrojtjes. A është parim kushtetues thelbësor gjykata e paanshme, a janë shkelje të rënda procedurale mosgarantimi i paanshmërisë dhe kufizimi i të drejtës së mbrojtjes?

A është në misionin e ILD verifikimi i zbatimit të dispozitave procedurale nga magjistratët?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përputhje me parashikimet ligjore bazuar në informacionin e bërë publik në media ka filluar verifikimin kryesisht të rastit dhe besoj jemi në përfundim, për të cilin do bëhet edhe njoftim publik.

Pyetja 6. *A është kryer verifikim prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të asaj që është referuar nga Prokurori i Përgjithshëm në Kuvend, se prokurorët e rinj nuk e dinë pozitën e tyre procedurale, komunikojnë me ambasadat e huaja për çështjet hetimore dhe gjyqësore që kanë në pro-*

ces? A ka shkelje të sekretit hetimor kur prokurorët japin informacion për çështjet me përfaqësues të shteteve të huaja?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Inspektori i Lartë i Drejtësisë për rastin konkret ka vendosur më herët fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë dhe në përfundim të këtij hetimi ka konkluduar se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistrates përbëjnë “Shkelje disiplinore e lehtë”, sipas nenit 102 pika 1 shkronjat “g” dhe “j” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe i ka propozuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike”, kërkesë që u rrëzua nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Pyetja 7. *A ka ndonjë raportim nga kryetarët e gjykatave në lidhje me respektimin e orarit zyrtar nga magjistratët? A mjaftojnë njoftimet në media, se megjithëse raportojnë ngarkesë në punë, magjistratët gjyqtarë punojnë part-time 2 ditë, në gjykatat ku janë emëruar dhe 3 ditë në Tiranë, për të verifikuar disiplinën në punë nëpërmjet sistemeve të kamerave të institucioneve përkatëse apo sistemit të menaxhimit të dosjeve?*

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Siç e përmenda edhe më sipër, marrë shkas nga disa ankesa, të cilat i janë nënshtruar verifikimit, por edhe informacionit të paraqitur nga vetë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, një problematikë e sistemit gjyqësor sot është produktiviteti dhe efektiviteti i magjistratëve në planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore si dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Për adresimin e kësaj situate Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar kryerjen e një inspektimi tematik në 9 gjykata të juridiksionit të përgjithshëm me objekt: “Mbi planifikimin dhe zhvillimin e seancave për një

periudhë 10 mujore”.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Pyetjet e deputetit Bardh Spahia.

Pyetja 1. *Duhet t’i keni ndjekur rastet e sulmeve të kryeministrit Edi Rama ndaj prokurores së Shkodrës Elsa Gjeli, si dhe gjyqtarëve të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Apelit Administrativ. Lidhur me këto sulme, a ka pasur nga ana e Kryeministrit apo Ministrit të Drejtësisë ankesa zyrtare të paraqitura pranë institucionit tuaj? Nëse po, sa është numri i këtyre ankesave dhe cilët janë gjyqtarët konkretë ndaj të cilëve është ankuar Kryeministri/Ministri i Drejtësisë? Në çfarë faze janë këto ankesa dhe a ka pasur vendimmarrje lidhur me to? Nëse po, cilat kanë qenë këto vendimmarrje dhe a mund të na shpjegoni çfarë ka rezultuar nga verifikimet/hetimet tuaja? E thënë ndryshe a ka rezultuar që sulmet e kryeministrit kanë pasur ndonjë bazë ligjore apo kanë qenë vetëm sulme politike nga një palë gjyq humbëse?*

Në këtë linjë pyetjesh, do të doja të dija edhe lidhur me ankesat që ka pasur ish-kryetari i Bashkisë Tiranë, tashmë nën arrest me burg, ndaj prokurorit Ols Dado dhe gjyqtarëve Erion Bani dhe Engert Pëllumbi. Kujtoj këtu për publikun që veçanërisht ndaj këtij prokurori, por edhe dy gjyqtarëve, ka pasur sulme të orkestruara publike dhe mediatike qoftë nga i burgosuri Veliaj, por edhe media të caktuara që sic rezultoi nga hetimet e SPAK kanë qenë sulme të orkestruara. Në çfarë faze janë këto ankesa, a ka pasur vendimmarrje lidhur me to dhe cilat kanë qenë këto vendimmarrje? Edhe në këtë rast, do të doja të dija nëse ka rezultuar ndonjë shkelje konkrete apo edhe këto sulme kanë qenë të natyrës politike? Meqënëse jemi te sulmet e kryeministrit Edi Rama. Në fakt ka pasur edhe sulme ndaj institucionit tuaj dhe ju personalisht, si një institucion që nuk po përmbushni detyrën, që nuk adresoni ankesat dhe nuk kërkon marrjen e masave ndaj prokurorëve dhe

gjyqtarëve që sipas tij kryejnë shkelje sepse nuk marrin vendimmarrje të pëlqyeshme për kryeministrin.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Ministri i Drejtësisë është subjekt i posaçëm i parashikuar nga ligji për të paraqitur pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ankesa të cilat ILD i shqyrton në përputhje me kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore. Disa prej këtyre ankesave kanë përfunduar dhe Ministria e Drejtësisë është njoftuar për vendimmarrjet përkatëse dhe disa ankesa të tjera janë në proces vlerësimi në kuadër të ushtrimit të kompetencave që ILD ka. Ndërkohë bashkëpunimi institucional me Ministrinë e Drejtësisë ka qenë i vazhdueshëm edhe në paraqitjen e propozimeve për kryerjen e inspektimeve tematike. Në total nga viti 2020 deri më tani, Ministria e Drejtësisë ka paraqitur Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 29 ankesa dhe është filluar hetimi disiplinor për 10 raste.

Në lidhje me ankesat konkrete të referuara ndaj magjistratëve specifikë, dëshiroj të sqaroj, se ILD i ka në proces shqyrtimi këto ankesa referuar parashikimeve ligjore dhe në mbrojtje të parimit të konfidencialitetit dhe mbrojtjes së integritetit të magjistratit nuk mund të ndajë detaje të mëtejshme në këtë fazë, por Inspektori i Lartë i Drejtësisë me proaktivitet vlerëson çdo burim informacioni publik dhe ankese individuale.

Pyetja 2. *Si i vlerësoni këto sulme? Si ndikojnë ato në punën e institucionit tuaj? A cenojnë pavarësinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? A ndihen inspektorët e ILD-së nën presion, trysni apo kërcënim nga pushteti ekzekutiv dhe kryeministri Edi Rama? Nuk kemi parë asnjë reagim ndaj këtyre sulmeve, dhe dua të kuptoj se cila ka qenë arsyeja që keni zgjedhur të heshtni ndaj deklaratave të Kryeministrit? Pra, cili ka qenë shqetësimi apo droja juaj ndaj këtyre sulmeve që ju kanë atakuar drejtpërdrejt*

dhe personalisht?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Për hir të së vërtetës, unë kam mbajtur qëndrim publik zoti Spahia, për çdo deklaratë publike politike dhe jo vetëm ato të thëna nga Kryeministri, por nga kushdo. Këtë e kam bërë edhe në rastin konkret me deklaratë të drejtpërdrejtë, edhe nëpërmjet punës sime. E fundit ishte dy javë para ndodhjes së fatkeqësisë në Gjykatën e Apelit, ku humbi jetën magjistrati, ku unë mbajta qëndrim, deklarova dhe dhashë këto mesazhe.

E para, gjyqtarët nuk mund të kërkojnë pavarësi vetëm politike, por duhet të kërkojnë pavarësi nga çdo interes tjetër.

E dyta, çdo kritikë apo çdo fyerje që shkon përtej kritikës normale të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve është antikushtetuese.

E treta, u kam kërkuar vetëpërmbytje gjyqtarëve dhe prokurorëve, sepse deontologjia apo niveli i deontologjisë politike që kanë politikanët, nuk duhet të diktojë sjelljen e magjistratëve. Ata janë në detyrë për të ushtruar detyrën në përputhje me ligjin.

Dhe e fundit, Kushtetuta dhe ligji kanë garantuar se çdo gjyqtar dhe prokuror të ndihet i lirë në ushtrimin e detyrës.

Ajo që dua të theksoj në fakt me këtë është që natyrisht kur ka deklarata politike, si çdo njeri, të gjithë kemi emocione, por mua nuk më lejohet të kem emocione në ushtrimin e detyrës sime. Unë do të bëj detyrën time për çdo deklaram që mund të jetë politik, për të parë nëse në atë deklaram politik ka elemente që lidhen me punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Pyetja 3. *Muajt e fundit ka një debat të madh*

për draftin e ri të Kodit Penal, të publikuar nga Ministria e Drejtësisë si produkt i punës së një grupi ekspertësh, që askush nuk di të thotë si janë përzgjedhur dhe çfarë metodologjie pune kanë ndjekur. Draft, i cili akoma nuk ka ardhur në Kuvendin e Shqipërisë. Megjithatë, pyetja që kam për ju është nëse:

Keni qenë apo jo pjesë e procesit të konsultimit të këtij drafti, dhe si profesionist i ligjit, por edhe shkak të funksionit tuaj të rëndësishëm kushtetues, do të doja të di cili është mendimi juaj për draftin e ri të Kodit Penal? A ndani ju fjala bie shqetësimet e Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorët të Përgjithshëm lidhur me teknikën legislative, numrin e lartë të neneve dhe kriminalizimin e shumtë të sjelljeve shoqërore? E bëj këtë pyetje, sepse nëse ky drafti vjen ndonjë ditë në tryezat e Kuvendit, mendimi juaj mund të na ndihmojë për qëndrimin që duhet të mbajnë edhe deputetët lidhur me të.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka qenë i përfshirë në procesin e draftimit të Kodit të ri Penal. Jemi vënë në dijeni të këtij kodi në fillim të shtatorit dhe na është dërguar për mendim. Natyrisht ky është një proces që kërkon kohë për shkak të volumit dhe vlerësimit skrupuloz dhe të kujdesshëm që duhet bërë për këtë dokument dhe kur të kemi një përgjigje do e bëjmë publike apo në konferenca që do organizohen, apo konsulta publike që do organizohen për këtë temë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Pyetje nga zoti Oerd Bylykbashi.

Qytetarët ankohen për kohën e gjatë të proceseve hetimore nga Prokuroria, ashtu si edhe për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore. A ka pasur ndonjë inspektim nga ana e institucionit tuaj për kohëzgjatjen e proceseve hetimore dhe

atyre gjyqësore? Nëse po, cilat kanë qenë gjetjet, konkluzionet dhe masat e rekomanduara nga këto inspektime? Nëse jo, a nuk vlerësoni se është brenda rolit tuaj që të adresoni një shqetësim kaq të madh të qytetarëve shqiptar që përballen me organet e drejtësisë për të kuptuar nëse zvarritja e hetimeve dhe proceseve gjyqësore vijnë si rezultat i mospërmbushjes në mënyrën e duhur të funksioneve të tyre nga gjyqtarë dhe prokurorë të caktuar?

Për të kuptuar këtë fenomen, besoj do të na ndihmonin edhe disa të dhëna nga ana juaj.

Sa është numri i ankesave që keni marrë lidhur me zvarritjen e hetimeve dhe proceseve gjyqësore? Sa prej këtyre ankesave janë duke u verifikuar? Sa prej këtyre ankesave janë arkivuar? Sa prej këtyre ankesave janë nën hetim? Për sa prej këtyre ankesave ka filluar procedimi disiplinor? Dhe në sa raste keni kërkuar marrjen e masave për prokurorë apo gjyqtarë nga Këshillat përkatës, KLP apo KLGJ? Në sa prej rasteve që keni kërkuar marrjen e masave, është pranuar kërkesa juaj?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Këto të dhëna në fakt i paraqita dhe në fjalën hyrëse, por nëse zoti Bylykbashi do t'i përsëris edhe njëherë...!

Kryetari i Kuvendit z. Niko Peleshi: Nëse keni kthyer përgjigje, vijoni me pyetjet e tjera.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: **Pyetja 2.** *Në fakt, u fol këtu për kohëzgjatjen e proceseve hetimore dhe atyre gjyqësore, të cilat sigurisht janë një shqetësim i madh. Por, në mënyrë të përsëritur, ne si deputetë marrim ankesa edhe lidhur me kohën e gjatë të trajtimit të ankesave nga institucioni juaj, Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Sipas ankesave që kemi marrë ne, verifikimi, shqyrtimi dhe hetimi i një ankese deri në një vendimmarrje konkrete mund të*

marrë edhe vite. Tani për të kuptuar më mirë këtë shqetësim qytetar, do të doja të dija:

Sa është kohëzgjatja e shqyrtimit të një ankese të paraqitur pranë institucionit tuaj? A e vlerësoni se kjo kohëzgjatje është përtej afatit të arsyeshëm? Dhe duke qenë se një ankese mund të marrë kohë të gjatë për shqyrtimin e saj, a shndërrohet kjo në një mekanizëm joefektiv për shkak se siç dihet pesë vite pas konsumimit të shkeljes disiplinore, ajo parashkruhet dhe nuk mund të fillojë procedimi disiplinor? Pra, kohëzgjatja a rrezikon që gjyqtarët dhe prokurorët që kryejnë shkelje disiplinore të mbeten të pandëshkuar, pasi shkeljet parashkruhet dhe ju gjendeni në pamundësinë ligjore për fillimin e procedimit disiplinor?

A po amnistohen prokurorët dhe gjyqtarët që shkelin ligjin për shkak të vonesave në shqyrtimin e ankesave ndaj tyre?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Kur filloi punë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në janar të vitit 2020, siç e kam përmendur edhe në Komisionin e Ligjeve, për gati një vit ILD ka punuar me vetëm një inspektor. Që në fillim të detyrës pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u transferuan 3 mijë ankese, diçka më pak nga institucionet e mëparshme dhe natyrisht nga të dhënat që kemi, nga këto ankese rreth 625 prej tyre erdhën të parashkruara. Me gjithë këtë backlog, apo numër të ankesash që erdhën edhe me numrin që vinin pranë ILD, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, krijoi, apo mori masa për të miratuar 3 urdhra me karakter të përgjithshëm për administrimin, kategorizimin, si dhe përcaktimin e mënyrës së trajtimit të ankesave, në mënyrë që edhe backlog-u të hiqej, por edhe të ishim në kohë për t'iu përgjigjur qytetarëve, veçanërisht për çështjen që ju ngritët, që ankesat të mos parashkruheshin pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Trajtimi i ankesave sipas metodologjisë që është

edhe publike është në faqen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, bëhet sipas një rendi përparësie bazuar në kritere si: data e dorëzimit; tipologjia ose urgjenca e trajtimit të ankesës; respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e secilës praktikë dokumentare.

Numri i ankesave siç ju thashë, në momentin kur erdhën në ILD të parashkruara ishte 625, prej të cilave 99 janë parashkruar në ILD, pra 1.3%, e totalit të ankesave të trashëguara nga organet e mëparshme (backlog). Vlerë e papërfillshme, nëse marrim në konsideratë se në këto vite është synuar ngritja e institucionit nga fillimi, krijimi dhe vendosja e standardeve të punës, unifikimi dhe njëtrajtshmëria e procedurave dhe në veçanti burimet e kufizuara njerëzore sa i takon numrit të inspektorëve ku edhe sot 5 vite pas ngritjes së tij ILD funksion me 50 përqind të kapacitetit të inspektorëve. Në çdo rast, nga ILD tregohet kujdes i shtuar, që pavarësisht mosndjekjes së afateve të trajtimit të ankesës, çdo pretendim i ngritur në ankese të trajtohet brenda afatit 5 vjeçar të parashkrimit, duke e adresuar nëpërmjet priorizimit të shqyrtimit të ankesave, ku afati i shkeljes së pretenduar është parësor. Njëkohësisht për shkak të standardit të vendosur, çdo rast, edhe nga hetimet, edhe nga vendimet e këshillave, veprimtaria e magjistratit kur vendoset fillimi i një hetimi disiplinor vlerësohet në kompleks (vonesat dhe/ose zvarritja) dhe për rrjedhojë magjistrati nuk amnistohet, edhe sikur të jetë parashkruar një ankese individuale.

Pyetja 3. *Qytetarët, por edhe mediat dhe shoqëria civile, vijojnë të ankohet për prokurorë dhe gjyqtarë që ushtrojnë detyrën e tyre në kushtet e konfliktit të interesit, të papajtueshmërisë me detyrë, në shkelje të rregullave të etikës dhe solemnitetit, në kushtet e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm apo edhe korrupsionit.*

A ka pasur inspektime nga ana juaj në zyra prokurorie apo gjykata të caktuara lidhur me këtë fenomen? Nëse po, cilat kanë gjetjet, konkluzionet dhe masat e rekomanduara nga këto inspektime? Nëse jo, a nuk vlerësoni se është brenda rolit tuaj që të luftoni nëpërmjet mekanizmave ligjore që keni në dispozicion, rastet e konfliktit të interesit, të nepotizmit, papajtueshmërisë, shkeljeve të etikës dhe solemnitetit, ushtrimit të ndikimit të paligjshëm dhe korrupsionit në prokurori dhe gjykata? Për të kuptuar akoma edhe më mirë ky fenomen, do të doja të na thuhet sa është numri i ankesave që keni marrë lidhur me problematikat e mësipërme?

Sa prej këtyre ankesave janë në verifikim? Sa është numri i ankesave të arkivuara? Sa është numri i ankesave nën hetim? Sa është numri i ankesave për të cilat keni filluar procedimin disiplinor? Sa është numri i ankesave që keni kërkuar marrjen e masës disiplinore?

Cilat kanë qenë vendimmarrjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjyqtarët e proceduar dhe Këshillit

të Lartë të Prokurorisë për prokurorët e proceduar?

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Një problematikë e adresuar në mënyrë vijuese edhe nga ankesat janë edhe pretendimet për cenim të parimit të paanshmërisë apo dhe konfliktit të interesit. Ligjvënësi ka adresuar nëpërmjet mekanizmave proceduralë garancitë e nevojshme për të siguruar të drejtat e palëve për gjykim nga një gjykatë e paanshme, nëpërmjet mundësisë së magjistratit për të kërkuar heqjen dorë nga gjykimi apo dhe procedimi dhe të drejtën e palëve pjesëmarrëse për të kërkuar përjashtimin/zëvendësimin e magjistratit. Respektimi i këtyre instituteve procedurale kontrollohet brenda shkallëve të sistemit gjyqësor. Edhe nga Gjykata e Lartë nuk janë konstatuar cenime të parimit të paanshmërisë apo gjykimit në kushtet e konfliktit të interesit, të tilla që të sjellin iniciimin e procedurave disiplinore, që duhet të konsiderohen masa e fundit ndëshkuese për magjistratin.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka adresuar stand-



ardin e zhvillimit të një gjykimi të paanshëm, edhe nëpërmjet inspektimeve tematike që përbëjnë detyrim ligjor, respektivisht inspektimi tematik mbi ndarjen e çështjeve me short në gjykata dhe caktimin e çështjeve në zyrat e prokurorisë. Nëpërmjet këtyre inspektimeve tematike Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka synuar të monitorojë procedurën e përzgjedhjes së gjyqtarit apo prokurorit nëpërmjet shortit me qëllim që të ofrohen garancitë e nevojshme të paanshmërisë dhe të parandalohet abuzimi i mundshëm në lidhje me formimin e trupit gjykues, nëpërmjet përdorimit të metodave selektive.

Për shkeljen disiplinore të papajtuësshmërisë, ose të konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislationit në fuqi, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është vendosur fillimi i hetimit disiplinor për 1 magjistrat gjyqtar dhe 4 anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Është paraqitur kërkesë për procedim për 1 magjistrat gjyqtar për shkarkim nga detyra, i cili është pezulluar deri në përfundim të procedurës së rivlerësimit kalimtar me vendimarrje përfundimtare të KPA. Ndërsa për 4 anëtarë këshilli është mbyllur hetimi disiplinor për pamjaftueshmëri të provave.

Pyetja 4. *Besoj jeni familjar me rastin e gjyqtarës së Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar Znj. Irena Gjoka/Maneku/Shpata, e cila rezultoi e dënuar në shtetin grek. Këtë dënim nuk e ka deklaruar as në formularin e dekriminalizimit, ashtu si edhe në procesin e saj të vetting-ut. Lidhur me këtë gjyqtare ka pasur në ankesë zyrtare nga Partia Demokratike.*

Në çfarë fazë është kjo ankesë? A janë kryer verifikimet paraprake dhe cila ka qenë vendimarrja deri në këtë fazë lidhur me këtë ankesë? Nëse janë kryer, çfarë ka rezultuar nga verifikimet tuaja? Nëse nuk janë kryer apo nëse ankesa është arkivuar, a nuk vlerësoni se

një gjyqtare e dënuar me vendim penal të formës së prerë në një vend të Bashkimit Evropian, dënim të cilin nuk e ka deklaruar në organet kompetente, kryen shkelje të rëndë disiplinore, për të cilën duhet të mbajë përgjegjësi?

Për të shmangur çdo përgjigje evazive, jam i qartë që kjo çështje trajtohet edhe nga Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, por do të doja të kuptoja qëndrimin tuaj lidhur me rastin në fjalë, apo edhe përtej rastit nëse mendoni që një gjyqtar apo prokuror i dënuar me vendim penal të formës së prerë, vendim të cilin e fsheh nga institucionet shtetërore, duhet të vazhdojë të qëndrojë në detyrë dhe të japë "drejtësi" për qytetarët.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Përgjigja është e njëjtë, si për pyetjen e mëparshme. Fakti që pretendohet ka natyrë penale siç edhe u evidentua nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky fakt është në hetim dhe vetëm në përfundim të hetimit penal Inspektori i Lartë i Drejtësisë do mund të vlerësojë mbi përgjegjësi disiplinore administrative të magjistrates.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Pyetja e deputetit Kapri...

Niko Peleshi: Faleminderit zoti Metani! Zoti Kapri nuk ndodhet në sallë.

Shumë faleminderit për pyetjet, tani vijojmë debatin sipas radhës.

Zoti Metani faleminderit!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Artur Metani: Faleminderit!



DËGJESË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË KUVEND

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani bëri një prezantim të veprimtarisë vjetore të institucionit që drejton për vitin 2024 në Komisionin për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike dhe Komisionin për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbiqëqyrjen Institucionale.

Duke u ndalur tek rekomandimet e lëna sipas Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, për vitin 2024, z. Metani bëri një sintezë të nivelit të zbatimit të tyre, duke nënvizuar se Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përmbushur plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna.

Më tej inspektori i Lartë i Drejtësisë evidentoi në shifra punën e bërë me trajtimin e ankesave, hetimet e procedimet disiplinore si dhe inspektimet tematike.

Në pjesën e fundit të prezantimit të vet, inspektori i Lartë i Drejtësisë paraqiti problematikat e evidentuara në sistem gjatë punës së vet inspektuese, rekomandimet e dhëna për të gjitha institucionet e drejtësisë dhe nevojën që edhe institucione të tjera publike të angazhohen për të adresuar këto problematika në sistem.

PARAQITJA E PLOTË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË NË KOMISIONIN PËR ÇËSHTJET LIGJORE DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE KOMISIONIN PËR NISMAT QYTETARE, BASHKËPUNIMIN DHE MBIQËQYRJEN INSTITUCIONALE

Përshëndetje të gjithëve,

Fillimisht, meqenëse është hera e parë që jam para kuvendit të ri, më lejoni t'ju uroj secilit

punë të mbarë, sidomos deputetëve të rinj. ankesave.
Suksese në Legjislaturën e 11-të!

Së dyti, më lejoni të vlerësoj rolin e rëndësishëm të Kuvendit në këtë situatë që kaluam dhe po kalojmë prej ngjarjes në fillim-javën e shkuar. Ajo që ndodhi ishte tronditëse për të gjithë. E falenderoj Kuvendin për aktin solemn, të nderimit të gjyqtarit me një minutë heshtje. Solidariteti njerëzor dhe institucional është jetik për t'u përballur me situata të tilla, ku gjetja e kufijve të duhur për të ndarë nga njëra anë problemet e sistemit, pakënaqësitë e bazuara dhe të pabazuara për punën e gjyqtarëve dhe të prokurorëve, dhe nga ana tjetër reagimet ekstreme me çmim shumë të rëndë, është shumë e vështirë.

Me këto ndjesi, kemi përgatitur me kolegët këtë raportim, duke paraqitur këtu jo vetëm shifra, por edhe një panoramë të problemeve të sistemit gjyqësor sot, sipas këndvështrimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si edhe sfidat që duhet të adresojmë, ne, organet e sistemit të drejtësisë, por edhe të tjerë aktorë institucionalë e publikë.

Sa i takon raportimit do ndalem në fillim tek rekomandimet e lëna, sipas Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në një sintezë të nivelit të zbatimit të tyre dhe për t'ju vënë në dijeni, se janë përmbushur plotësisht të gjitha rekomandimet e lëna.

Rekomandimi 1. Të adresojë nëpërmjet instrumenteve që i jep ligji problematika të ndjeshme për publikun, si institucion garantues i sistemit të drejtësisë, me qëllim fuqizimin e mëtejshëm të besimit të publikut jo vetëm për ILD-në, por për të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë.

Në planin vjetor të inspektimeve të ILD-së, tematikat e tyre përfshijnë:

Problematikat e evidentuara nga shqyrtimi i

Vlerësimi i pretendimeve më të shpeshta për shkelje të ndryshme nga ana e magjistratëve, administratës së gjykatave apo prokurorive.

Propozimet e ardhura nga institucionet, të cilat bëhen në përputhje me parashikimet e nenit 194, pika 4 e ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", të ndryshuar.

Të dhënat e paraqitura nga informacion periodik i gjykatave.

Dispozitat e zbatueshme që parashikojnë ndërmarrjen e inspektimeve.

Rekomandimi 2. Vëmendje e veçantë plotësimi të vakancave në pozicionet e inspektorit magjistrat dhe të inspektorit jomagjistrat.

Inspektori i Lartë të Drejtësisë i ka dhënë vëmendje të veçantë procesit të plotësimi të vakancave në pozicionet e inspektorit magjistrat dhe të inspektorit jomagjistrat, duke:

Paraqitur kërkesa për komandim të magjistratëve në Këshilla.

Shpallur vakancat dhe nxjerrjen e urdhrit për fillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rekomandimi 3. Ndërmarrjen e masave të rregullta për kontrollin e figurës dhe të pasurisë/integritetit në përputhje me standartet e larta të procesit të rivlerësimit, veçanërisht për inspektorët jomagjistratë.

Procesi i verifikimit të kontrollit të figurës dhe

të pasurisë/integritetit për kandidatët për inspektor jomagjistrat është realizuar në përputhje me kriteret ligjore (neni 209, pika 6; nenit 283 pika 4; nenit 240 të ligjit nr. 115/2016), duke ushtruar kontroll të plotë dhe të gjithanshëm me organet ligjzbatuese për të verifikuar përbushjen e kriterëve.

Verifikimi konsiston në 3 shtylla, për të cilat kryhet verifikim i plotë dhe gjithëpërfshirës për secilin kandidat, lidhur me:

- Kontrollin e plotë të deklaratës së pasurisë, të interesave private dhe detyrimet financiare të kandidatit dhe të personave të lidhur.
- Verifikimin e pastërtisë së figurës, duke iu referuar standardeve të ligjit për rivlerësimin kalimtar.
- Verifikimin e kriterëve ligjore për vlerësimin e profesionalizmit të kandidatit, duke iu referuar standardeve të KED për këtë kriter.

3 (tre) kandidatë janë ndaluar për kriterin e pasurisë dhe 5 (pesë) kandidatë për kriteret të tjera.

Rekomandimi 4. Rritja e numrit të inspektimeve institucionale me objektiv të qartë dhe të përcaktuar, të fokusuara në aspektet specifike të veprimtarisë së gjykatave dhe zyrave të prokurorisë për menaxhimin e çështjeve dhe administrimin gjyqësor dhe hetimor.

Ky rekomandim është realizuar duke rritur numrin e inspektimeve, përmes fuqizimit të mekanizmeve të brendshëm për përcaktimin e tematikave në planin e inspektimeve.

– ILD ka ngritur mekanizmin administrativ të monitorimit të veprimtarisë së magjistratëve, përmes marrjes së informacionit periodik nga gjykatat, duke evidentuar kështu ato fenomene, të cilat janë përfshirë në tematika inspektimi, që lidhen me cilësinë dhe eficiencën e sistemit. Marrëdhënia me Gjykatën e Lartë për vendimet



të cilat referohen në ILD, në kuadër të zhvillimit të procesit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm dhe pjesëmarrja aktive në analiza vjetore të punës së gjykatave kanë ndikuar në rritjen e numrit të inspektimeve.

– Konkluzionet e analizave nga shqyrtimi i ankesave të publikut dhe rastet e denoncuar në publik, apo edhe kërkesat e ardhura nga institucione të ndryshme kanë shërbyer si mjet i rëndësishëm për të përcaktuar tematikat e planit të inspektimeve.

– Propozimet e institucioneve të sistemit të drejtësisë gjithashtu kanë qenë një burim i rëndësishëm informacioni.

Të gjitha këto masa kanë shërbyer në përcaktimin e tematikave të planit të inspektimeve, me fokus cilësinë e veprimtarisë gjyqësore.

Për vitin 2025, është miratuar plani i inspektimeve, që përmban 8 tematika inspektimi,

të cilat kanë në fokus cilësinë dhe eficiencën e sistemit, duke përfshirë 3 inspektime, që lidhen me sistemin prokurorisë. Për herë të parë është parashikuar kryerja një inspektimi institucional.

Rekomandimi 5. Përfundimi i vlerësimit etiko-profesional të inspektorëve në një kohë të arsyeshme dhe rezultatet e vlerësimit të përdoren për të zhvilluar programe trajtimi në drejtim të përmirësimit të performancës institucionale.

Procesi i vlerësimit etiko-profesional për 5 inspektorë është përmbyllur dhe aktualisht ka përfunduar edhe procesi për inspektorët magjistratë. Mbeten për vlerësim 2 inspektorë, procesi për të cilët do të fillojë, gjatë vitit 2026.

Rekomandimi 6. Angazhimi për të rritur bashkëpunimin me institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë dhe Ministrinë e Drejtësisë në drejtim të shkëmbimit të informacionit, bashkëpunimit në hetime dhe inspektime tematike, si dhe



koordinimin e veprimeve për të adresuar çështje të përbashkëta.

Për sa i takon kësaj çështjeje, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është angazhuar për të rritur bashkëpunimin, duke marrë pjesë në takime, ku ka bërë thirrje të vazhdueshme për tryeza të përbashkëta midis organeve të sistemit të drejtësisë, për të nxitur diskutime rreth çështjeve, që rrisin cilësinë dhe eficienën e gjyqësorit dhe prokurorisë. Disa raste për ilustrim:

Qershor 2024, përfaqësues të ILD-së, KLGJ-së dhe KLP-së, u angazhuan në një tryezë të rrumbullakët, në funksion të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve të drejtësisë, me fokus të veçantë në vlerësimin e vazhdueshëm të gjyqtarit dhe prokurorit.

Dhjetor 2024, u zhvillua një mbledhje pune në Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Qëllimi i

takimit ishte adresimi i sfidave që lidhen me komunikimin institucional dhe forcimi i mëtejshëm të bashkëpunimit mes dy institucioneve, për një sistem drejtësie efikas dhe më të qëndrueshëm, përmes tematikave për inspektim në drejtim të disiplinës në punën e magistratëve.

Takime të ngjashme kanë vijuar edhe gjatë vitit 2025, me fokus tematikat e inspektimit, në funksion të cilësisë dhe eficiencës së sistemit gjyqësor dhe ndjekjes së rekomandimeve të inspektimit, e padyshim do jenë të vazhdueshme.

Rekomandimi 7. Përmirësimi i treguesve të transparencës dhe aksesueshmërinë e publikut duke publikuar informacione periodike, raporte dhe çdo të dhënë tjetër që reflekton veprimtarinë institucionale.

Treguesit e transparencës mbeten prioritet sistematik për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë,



që prej nisjes së funksionimit. Kjo konstatohet së pari nga faqja jonë zyrtare, e cila është përmirësuar edhe gjatë vitit 2024 me këtë pikësynim. Kjo ka sjellë edhe vlerësimin maksimal të Komisionerit për të drejtën e informimit, për të dytin vit radhazi për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. Në filozofinë e ILD-së, mundësia për të shfrytëzuar çdo hapësirë të re për përmirësim, mbetet një angazhim i vazhdueshëm.

Rekomandimi 8. Angazhimi në përmbushjen me efektivitet të plotë të gjitha detyrimet institucionale në kuadër të raportimeve, duke kontribuar në kohë në raportimet në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

Angazhimet në drejtim të integritetit evropian kanë qenë prioritet absolut për ILD-në, përmes raportimeve në kohë dhe me cilësi, sa herë që është kërkuar pranë strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, me të dhëna të përditësuara periodikisht. Gjithashtu ILD ka marrë pjesë gjithmonë në gjitha tryezat të nivelit të lartë, vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, apo përfaqësuesit e autorizuar, në tryezat teknike, takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integritimin Evropian, takimet shpjeguese dhe koordinuese të thirrura në funksion të angazhimeve të procesit të integritetit. Enkas për këtë rekomandim është vlerësuar edhe rishikimi i strukturës organizative, në mënyrë që të realizohet me efektivitet procesi i përmbushjes së angazhimeve për këtë proces dhe presim miratimin nga Kuvendi.

Natyrisht përveç detyrave të lëna nga Kuvendi në rezolutë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vijuar punën me funksionet e veta organike, që lidhen me ankesat, hetimet e procedimet disiplinore dhe inspektimet tematike. Siç dihet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore, fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të

gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorive.

Kështu, gjatë vitit 2024 janë depozituar pranë ILD, 1491 ankesa të reja ndaj gjyqtarëve e prokurorëve. 1363 ankesa vijuan të mbartura nga vitet e mëparshme. Në total, për vitin 2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kishte 2854 ankesa për trajtim. Nga këto, janë shqyrtuar 1374 ankesa, nga të cilat 54 kanë përfunduar me hetim disiplinor. Përveç qytetarëve, ankues gjatë vitit 2024 ka patur edhe institucione të sistemit, si kryetar gjykate me 2 ankesa, drejtues të prokurorive me 20 ankesa, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me 2 përcjellje për kompetencë dhe Gjykata e Lartë me 4 vendimmarrje për konstatim të shkeljes së afatit të arsyeshëm.

Përveç ankesave më sipër, gjatë vitit 2024, ILD ka shqyrtuar edhe një numër të konsiderueshëm kërkesash nga KLP e KLGJ, për vlerësimin e magjistratëve për periudha të ndryshme vlerësimi. Për 118 kërkesa të sjella nga Këshillat, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka shqyrtuar 674 ankesa dhe janë në faza të ndryshme trajtimi 11 ankesa. Konkretisht, 578 ankesa janë shqyrtuar, bazuar në 64 kërkesat që ka sjellë KLGJ dhe 9 ankesa janë në faza të ndryshme trajtimi. Ndërsa 96 ankesa janë shqyrtuar për KLP, bazuar në 54 kërkesat që i janë drejtuar ILD-së dhe 2 ankesa janë në fazë shqyrtimi fillestar. Edhe gjatë vitit korrent, dy Këshillat kanë përcjellë kërkesa për ILD në kuadër të nevojës për vlerësimin e magjistratëve. 71 kërkesa kanë ardhura nga Këshillat deri në fund të shtatorit, për të cilat ILD ka shqyrtuar 842 ankesa dhe 5 ankesa janë në fazë verifikimi. Pra vetëm për vitin 2024 deri në shtator 2025 janë 1534 ankesa për trajtim nga ILD me kërkesë të Këshillave. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka trajtuar 1516 ankesa, vetëm 18 ankesa janë në proces. Pra është një



punë voluminoze dhe trajtimi i tyre bëhet me prioritet për të mos penguar KLGJ-në e KLP-në në proceset e vlerësimit të gjyqtarëve e prokurorëve, edhe në funksion të ngritjeve në detyrë e transferimeve, sipas nevojave të Gjykatave e Prokurorive për të plotësuar vakancat e tyre.

Krahas trajtimit të këtyre dy kategorive të ankesave, gjatë vitit 2024 janë përfunduar 6 inspektime tematike, ndërsa në nisje të vitit kalendarik si zakonisht, Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve ka miratuar kalendarin me 6 inspektime tematike.

Nga ankesat e shqyrtuara gjatë vitit 2024, ankuesit ngrenë pretendime:

mbi mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjyqësore dhe vlerësimit të provave.

për vonesa në shpalljen dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

për kryerjen e veprimeve/moskryerjen e vepr

meve hetimore, apo vlerësimin e provave të grumbulluara nga organi hetimor gjatë procesit hetimor.

për vendimmarrjeve të padrejta të magistratëve gjatë shqyrtimit të çështjeve.

për zvarritje të gjykimit nga ana e gjyqtarëve por edhe zvarritje të veprimtarisë hetimore nga prokurorët

për papajtueshmëri apo konflikt interesi dhe shkelje të etikës nga magistratët.

Gjatë vitit 2024, nga ankesat për të cilat ka nisur hetim disiplinor, ILD ka nxjerrë 23 vendime për 25 magistratë (11 prokurorë, 13 gjyqtarë dhe 1 anëtar këshilli), nga të cilat, 10 vendime të nisura me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjatë vitit 2024 janë vijuar edhe hetimet e filluara nga viti 2023.

Nga hetimet e nisura me iniciativë, në dy raste Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka kryer edhe he



time pasurore, nisur nga të dhënat e denoncuar në publik. (Një gjyqtar i denoncuar në një emision investigativ dhe një anëtar Këshilli gjatë komunikimit në një mbledhje plenare).

Gjatë vitit 2024, ka një dyfishim të kërkesave për procedim disiplinor, krahasuar me një vit më parë. Konkretisht për këtë vit janë 11 magjistratë të proceduar, 6 gjyqtarë dhe 5 prokurorë për shkelje disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit, si:

Vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale.

Mosrespektim i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë.

Mosparaqitja e kërkesës për heqje dorë nga procedimi ose gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit; shkelje e rregullave të papajtueshmërisë ose të parandalimit të

konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Përdorimi i statusit të magjistratit, me qëllim krijimin e përfitimeve për vete ose për të tjerët.

Veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin.

Shkelja e përsëritur ose e rëndë e rregullave të solemnitetit, rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me palët, subjektet e tjera të përfshira në proces, me kryetarin, magjistratët e tjerë, si dhe me personelin e administratës gjyqësore.

dhe raste kur gjyqtari është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Kështu për 6 gjyqtarë është propozuar masa disiplinore “shkarkim nga detyra” (2 kërkesa janë pranuar, 1 kërkesë është rrëzuar; 1 kërkesë është pezulluar; 2 kërkesa janë në pro-

5 prokurorë janë dërguar për procedim disiplinor në KLP. Për 2 raste është propozuar “Vërejtje konfidenciale”; 3 raste “Ulje e përkohshme e pagës deri në masën 40% për një periudhë njëvjeçare”. (1 kërkesë është pranuar dhe 2 janë rrëzuar, 2 në proces gjatë 2024.)

ces në vitin e raportimit)

5 prokurorë janë dërguar për procedim disiplinor në KLP. Për 2 raste është propozuar “Vërejtje konfidenciale”; 3 raste “Ulje e përkohshme e pagës deri në masën 40% për një periudhë njëvjeçare”. (1 kërkesë është pranuar dhe 2 janë rrëzuar, 2 në proces gjatë 2024.)

Sa i takon verifikimit me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nxitës janë së pari, dinamikat e proceseve të punës dhe të dhënat që vijnë nga disa burime. P.sh. gjatë vitit 2024, nga të dhënat e dala nga 4 inspektimet tematike të përfunduara, janë verifikuar 11 raste individuale (për 3 raste ka filluar hetimi disiplinor, 4 raste janë arkivuar pas verifikimit, pasi nuk janë konstatuar shkelje që justifikojnë hetimin dhe 4 raste janë në proces verifikimi).

Burim tjetër kanë qenë informacionet e bëra në publik dhe denoncimet e bëra në media, si psh. komunikimi publik të ministrit të Drejtësisë, sipas të cilit pas fillimit të zbatimit të ligjit nr. 33/2024 “Për dhënie amnistie”, janë shfaqur problematika të diktura nga sjellja e magistratëve në drejtim të zbardhjes së vendimeve gjyqësore, nxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit, apo çështjeve të tjera që lidhen me veprimtarinë e magistratëve. Nisur nga ky komunikim publik, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar 19 vendime verifikimi, të cilat janë në proces.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është institucion i kontrollueshëm në punën e vet, pasi vendimet e tij janë të ankimeshme. Gjatë vitit 2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë 762 vendime objekt ankimi pranë Komisioneve të Përkohshme të Shqyrtimit të Ankimeve në Këshilla. Vetëm 89 nga 762 vendimet e ILD-së janë ankimuar. Komisionet përkatëse pranë KLGJ e KLP kanë vendosur refuzimin, si të pabazuar të ankimit të paraqitur nga ankuesit ndaj vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e për pasojë, asnjë prej vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk është cenuar.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka administruar e shqyrtuar raste, edhe për gjykatat e prokuroritë më të larta të sistemit, si dhe Këshillat, bazuar në ankesa apo inicime, si gjatë vitit 2024, por edhe që prej nisjes së funksionimit të institucionit në vitin 2020, për të patur një panoramë të shtrirë ndër vite të kontrollit të ILD-së në këto institucione. Dua t’ju sjell në vëmendje që një ankesë mund të jetë për 1 ose më shumë magistratë.

Gjatë vitit 2024 janë depozituar në ILD:

18 ankesa ndaj Prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. ILD ka trajtuar gjithsej 25 ankesa për subjektet e posaçme të SPAK

4 ankesa për subjektet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar. Janë trajtuar gjithsej 12 ankesa për subjektet e posaçme të GJKKO

3 ankesa për subjektet e Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Është trajtuar 1 ankesë për subjektet e posaçme pranë kësaj Gjykate (GJPAKKO)

24 ankesa për anëtarët e Gjykatës së Lartë

Nëse do keni interes, po ju përcjell një panoramë më të shtrirë në kohë, totalin e ankesave për institucionet e epërme të drejtësisë, për periudhën 2020 – 30 Shtator 2025.

158 ankesa ndaj Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), prej të cilave janë trajtuar 108 ankesa dhe janë në proces 50 ankesa.

74 ankesa për subjektet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, prej të cilave trajtuar 58 ankesa dhe janë në proces 16 ankesa.

83 ankesa për subjektet e Gjykatës së Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, prej të cilave trajtuar 73 ankesa dhe janë në proces 10 ankesa.

206 ankesa për Anëtarët e Gjykatës së Lartë, prej të cilave janë trajtuar 131 ankesa dhe janë në proces 75 ankesa.

24 ankesa për anëtarët e KLGJ, prej të cilave trajtuar 22 ankesa dhe janë në proces 2 ankesa.

7 ankesa për anëtarët e KLP prej të cilave janë trajtuar 4 ankesa dhe janë në proces 3 ankesa.

13 ankesa për prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, prej të cilave janë trajtuar 12 ankesa dhe është në proces 1 ankesë.

Inspektimet tematike janë dimensionin e dytë funksional i punës së ILD-së, pas ankesave. Siç e thashë në krye, gjatë vitit 2024 janë finalizuar 6 inspektimet tematike. Konkretisht: 2 inspektime për ndarjen e çështjeve me short, si dhe kontrolli elektronik i raporteve të sistemit elektronik, monitorim për periudha të viteve 2022 dhe 2023; 1 inspektim mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve 2023; 1 inspektim mbi caktimin e çështjeve në prokurori 2023; 1 inspektim mbi dokumentimin nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim.

Për këto 6 inspektime janë lënë 54 rekomandime, ku 9 rekomandime lidhen me marrjen e masave për miratim/nxjerrje aktesh, 29 rekomandime për ndërmarrjen e veprimeve administrative dhe 15 rekomandime për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë. (5 janë monitoruar)

Në nisje të vitit 2024 është miratuar kalendari për 6 inspektime tematike për këtë vit, bazuar në propozime të atyre institucioneve që kanë sjelle propozime për inspektime, por edhe indicie të marra nga trajtimi i ankesave të administruara dhe angazhime në kuadër të procesit të integritetit. Temat janë:

Ndarja e çështjeve me short dhe kontrolli elektronik i raporteve të sistemit elektronik,

Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve,

Mbi caktimin e çështjeve në prokurori,

Mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore,

Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore,



Dokumentimi nga gjyqtarët i informimit të palëve rreth mundësisë për zgjidhjen e çështjes me ndërmjetësim

Krahas kësaj panorame në shifra të veprimtarisë për vitin 2024, dua të ndaj me ju edhe një panoramë, bazuar në rolin detektues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, mbi problematikat që na vijnë nga ankesat dhe inspektimet që bëjmë, të cilat i evidentojmë dhe referojmë.

Nga veprimtaria e vet, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka evidentuar disa problematika dhe konkluzione.

Kohëzgjatja e gjykimeve tej afateve të arsyeshme zvarritja e veprimeve hetimore dhe vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore

Efektiviteti dhe standardi i sistemit të drejtësisë, nuk është në nivelin e duhur dhe të kënaqshëm për qytetarët shqiptarë. Për sa vërehet, problematike vijon të mbetet tejzgjat-

ja e proceseve gjyqësore, një problem i evidentuar në mënyrë të vazhdueshme nga ankesat, jurisprudenca e GJEDNJ, por dhe në raportet e organizmave ndërkombëtare. Në vendim-marrjen e saj të fundit, GJEDNJ ka adresuar edhe rekomandime konkrete për autoritetet vendase, duke theksuar nevojën e plotësimit të vakancave në Gjykatën Administrative të Apelit dhe Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Tejzgjatja e proceseve gjyqësore ndikon drejtpërdrejtë në perceptimin dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, rritja e besimit të të cilit është një nga shkaqet kryesore, për të cilën u ideua dhe u ndërmor reforma në drejtësi.

Nëpërmjet instrumenteve ligjorë në dispozicion, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka adresuar këtë problematikë, nëpërmjet rekomandimeve të natyrës rregullatore dhe administrative, që kanë rezultuar nga inspektimi tematik i kryer pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore, gjatë periudhës 01.03.2023-31.05.2023, inspektim

tashmë i konkluduar me rekomandime konkrete për aktorët e sistemit të drejtësisë.

Nga ky inspektim tematik rezultoi se:

Arsyeja e parë që ka ndikuar në kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore tej afateve të arsyeshme është ngarkesa e magjistratëve të kësaj gjykate. Për vitin 2023, ngarkesa mesatare e punës për një gjyqtar të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka qenë mesatarisht 1176 çështje për gjykim, ndërkohë që për gjyqtarët pranë gjykatave të të njëjtit nivel gjyqësor ka qenë 841.7 çështje për gjyqtar. Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë rezulton të jetë gjykata me numrin më të lartë të çështjeve të mbartura për vitin 2023, me një numër total 19275 çështje që përbën 48% të stokut total për gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Po ashtu, kjo gjykatë rezulton të ketë regjistruar edhe numrin më të lartë të çështjeve të reja gjatë vitit 2023, konkretisht 31833 çështje, që përbëjnë 38% të totalit të çështjeve të regjistruara në nivel kombëtar për këtë grup gjykatash. Për vitin 2023, numri i gjyqtarëve në organikën e miratuar të kësaj gjykate është 80 gjyqtarë, ndërkohë që efektivisht kanë ushtruar detyrën gjatë vitit 2023, vetëm 43 gjyqtarë. Gjatë periudhës objekt inspektimi, në Dhomën Civile kanë ushtruar funksionin 26 gjyqtarë, të cilët kanë shpallur 1748 vendime gjyqësore civile me palë kundërshtare.

Arsyeja e dytë janë vakancat e paplotësuara pranë kësaj gjykate. Nga ky inspektim rezultoi se organika e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Penale dhe Civile) për vitin 2023, rezulton e plotësuar në masën 54%, sa i takon kësaj trupe. Duke vlerësuar rëndësinë që ka plotësimi i vakancave në sistem, nisur nga raportet e Komisionit Evropian dhe Raportit të vitit 2025 për Shtetin e së Drejtës, Inspektori i Lartë i

Drejtësisë i ka rekomanduar Këshillit të Lartë Gjyqësor, si institucioni përgjegjës për ndjekjen e çështjeve të burimeve njerëzore në gjykata, marrjen e masave efektive dhe të menjëhershme për plotësimin e organikës e kësaj gjykate, duke vendosur edhe një afat 1 vjeçar për përmbytjen e tij. Nga ana jonë do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmbytja e këtij rekomandimi, brenda fushës së kompetencave që ILD ushtron.

Arsyeja e tretë është infrastruktura, por këtë çështje do ndalem në vijim të prezantimit.

Nga ana tjetër, në të gjitha ato raste ku ILD, në kuadër të verifikimit dhe hetimit disiplinor ka konstatuar se vonesat apo zvarritjet kanë tejkaluar çdo afat të arsyeshëm, duke demonstruar neglizhencë të magjistratit në përmbytje të detyrës, për shkaqe të palidhura me arsye jashtë kontrollit të magjistratit, ka paraqitur kërkesat për procedimin disiplinor pranë këshillave përkatës. Në total, në rastet e vonesave dhe zvarritjeve në gjykim apo procedim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor për 51 magjistratë dhe në përfundim të tyre janë paraqitur kërkesat për procedim disiplinor për 17 magjistratë, 8 gjyqtarë dhe 9 prokurorë. Masat e propozuar për këto shkelje disiplinore janë:

“Shkarkim nga detyra” – për 2 gjyqtarë dhe 3 prokurorë;

“Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit”- për 3 gjyqtarë dhe 5 prokurorë;

“Vërejtje publike” – për 3 gjyqtarë dhe 1 prokuror.

Një inspektim tjetër i zhvilluar nga ILD është edhe përdorimi i mekanizmave alternativë të

gjykimit. Ky inspektim është zhvilluar pranë gjykatave së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Elbasan, Tiranë, Durrës dhe Vlorë dhe nga inspektimi është konstatuar, se ndërmjetësimi është përdorur në mënyrë shumë të kufizuar, pavarësisht detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 25 të Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim të këtyre inspektimeve është rekomanduar ndër të tjera, pasqyrimi i çdo orientimi të gjyqtarit për ndërmjetësim në procesverbalet e seancave gjyqësore, në mënyrë që të mundësohet monitorimi dhe analizimi i kësaj praktike në inspektimet pasardhëse.

Për të monitoruar veprimtarinë e prokurorëve, në kuadër të ankesave të vazhdueshme për zvarritje të veprimtarisë hetimore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka iniciuar inspektimin tematik të çështjeve, për të cilat prokurori ka proceduar me kërkesë ose vendimmarrje për pushim, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale përgjatë vitit 2024. Nëpërmjet këtij inspektimi dhe inspektimit institucional, që po zhvillohet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë, mbi të gjithë procesin e qarkullimit të dokumentacionit në këtë zyrë prokurorie, Inspektori i Lartë i Drejtësisë synon jo vetëm të evidentojë problematikat, por dhe të adresojë çështje të aspektit sistematik.

Arsyetimi me vonesë i vendimeve gjyqësore, përbën një tjetër problem sistematik me impakt në të drejtën e individëve për një proces të rregullt ligjor. Inspektori i Lartë i Drejtësisë duke reflektuar dhe rekomandimet e lëna për veprimtarinë e këtij institucioni gjatë vitit 2023 në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, ka vendosur kryerjen e inspektimeve tematike në disa gjykata të juridiksionit të përgjithshëm dhe në një gjykatë të juridiksionit administrativ. Nëpërmjet këtyre inspektimeve tematike,

ILD ka bërë një fotografim të situatës së dorëzimit të vendimeve gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Shkodër dhe aktualisht është në përmblyllje të inspektimit tematik pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë. Në përfundim të çdo inspektimi, ILD ka vlerësuar të identifikojë një periudhë kohe të arsyeshme, që i nevojitet magjistratit për dorëzimin e vendimit përfundimtar të arsyetuar, duke marrë në konsideratë mesataren e kohës, që i nevojitet çdo magjistrati në të njëjtën gjykatë për arsyetimin e vendimeve lidhur me çështje të të njëjtës tipologji. Afati i vlerësuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë në përfundim të çdo inspektimi, nuk zëvendëson në asnjë rast afatin ligjor, por përbën një konstatim nga ILD në momentin e kryerjes së inspektimit, duke mbajtur në konsideratë situatën aktuale të ngarkesës që ka sistemi sot dhe vakancat në sistemin e drejtësisë. Në këtë kuadër, personalisht mendoj se angazhimi i gjykatës, KLGJ-së, apo dhe vetë Kuvendit, për të hartuar dhe miratuar masa me qëllim reduktimin e backlogut, i cili ka arritur në një numër të madh është një mjet i domosdoshëm.

Infrastruktura e gjykatave dhe regjistrimi i seancave audio

Një tjetër problematikë me të cilën po ballafaqohen gjykatat sot është mënyra e zhvillimit të seancave gjyqësore në kushtet e mungesës së infrastrukturës së nevojshme për respektimin e kërkesave procedurale për zhvillimin e gjykimit me regjistrim audio. Nga përmbajtja e ankesave, verifikimeve dhe informacionet periodike që administrohen në ILD ka rezultuar, se infrastruktura aktuale nuk mundëson zhvillimin e të gjithë seancave

gjyqësore sipas detyrimit ligjor me regjistrim audio, kjo në veçanti në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Këto mangësi së bashku me vakancat në sistem kanë ndikuar në cilësinë e kushteve të punës, duke ekspozuar trupën gjyqësore në mungesë të solemnitetit të zhvillimit të proceseve gjyqësore.

Gjatë realizimit të inspektimit në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me objekt kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore është evidentuar kjo problematikë dhe ILD ka rekomanduar, që Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me Kryetarin e Gjykatës dhe Këshillin e Gjykatës, të marrin masat e nevojshme për të garantuar shfrytëzimin e ambienteve të gjykatës, në mënyrë që gjykimi i të gjitha çështjeve civile me palë kundërshtare të zhvillohet në salla gjykimi të pajisura me regjistrim audio, brenda 6 muajve të parë të vitit 2026.

Respektimi i solemnitetit të gjykimit dhe i standardeve etike

Respektimi i rregullave të etikës dhe solemnitetit është në fokus të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sjellja e magistratit është e lidhur me garantimin e ruajtjes e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Në çdo procedim disiplinor të iniciuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përpjekur të ruajë balancën, ndërmjet mungesave dhe sfidave, me të cilat po përballen magistratët në punën e tyre, me detyrën që magistrati ka për të shfaqur një model sjellje, i cili mbart vlera, të cilat jo vetëm duhet të transmetohen, por edhe të shfaqen, gjatë ushtrimit dhe jashtë ushtrimit të funksionit. Në rastet kur sjellja jo-etike është faktuar gjatë kryerjes së hetimit disiplinor janë përcjellë propozimet për marrjen e masave disiplinore nga Këshillat.

ILD ka vendosur hetimin disiplinor për 14 magistratë, 10 gjyqtarë dhe 4 prokurorë për cenim të rregullave të etikës dhe në përfundim të tyre janë paraqitur kërkesat për procedim për 7 magistratë, 3 gjyqtarë dhe 4 prokurorë duke propozuar:

“Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit” për 2 magistratë.

“Vërejtje publike” për 3 magistratë.

“Vërejtje konfidenciale” për 2 magistratë.

Masa ndëshkuese siç është evidentuar në mënyrë të vazhdueshme është mjeti i fundit, që duhet të zbatohet për të garantuar përgjegjshmërinë e sistemit. Për këtë arsye, vlerësoj se nga Këshillat përkatëse duhet të kenë një bashkëpunim më të ngushtë me Shkollën e Magistraturës në trajnimin vazhduesh të magistratëve, veçanërisht atyre me më pak vite përvojë në sistem, në kuadër të shpeshimit të trajnimeve dhe individualizimit të tyre për rastet e referuar nga ILD dhe rastet për të cilat është vendosur marrja e masave disiplinore. Njëkohësisht vëmendje duhet t'i kushtohet edhe trajnimit vazhduesh të magistratëve të tjerë, në përgatitjen e tematikave me efekt ndërgjegjësues dhe parandalues për shmangien e sjelljeve të tilla në të ardhmen, të cilat mund të kenë impakt serioz në perceptimin e publikut për sistemin e drejtësisë.

Qëndrimet në lidhje me vendimmarrjet gjyqësore dhe roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në raport me këtë problematikë

ILD vlerëson të ritheksojë, se roli i tij në shqyrtimin e pretendimeve për vendimmarrje të padrejta nga aktorët e sistemit të drejtësisë, nuk mund të zëvendësojë interpretimin dhe

zbatimin, që prokurori i bën normave dhe instituteve procedurale penale, apo dhe shqyrtimin e pavarur gjyqësor që bën gjykata. Kjo është kompetencë e organeve të sistemit të drejtësisë, e cila kontrollohet në themel nga organizimi hierarkik i vetë gjyqësorit, nëpërmjet mekanizmave procedurale të parashikuara nga ligji. Në përputhje me kompetencat e tij kushtetuese dhe ligjore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë bën një analizë të pavarur të fakteve të pretenduara në përmbajtjen e ankesave, e cila është e pandikuar nga pretendimet që ngrihen nga subjektet ankuese, përfshirë këtu dhe nga subjekte, që kanë detyrimin ligjor për parashtrimin e të dhënave të besueshme për kryerjen e një shkelje disiplinore (siç është rasti i Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme apo dhe drejtuesve të zyrave të prokurorisë apo kryetarëve të gjykatave).

Elementi i përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, sipas qëndrimeve tashmë të vendosura edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, del në pah kur magjistrati gjatë vendimmarrjeve të tij vepron në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin, apo praktikën unifikuese të gjykatave më të larta duke deformuar bindjen e brendshme, e cila duhet të jetë në përputhje me ligjin, analizën e fakteve dhe provave. Edhe cenimi i vendimmarrjes brenda shkallëve të gjyqësorit është pjesë e kontrollit të vendimeve gjyqësore dhe ushtrimit të hierarkisë të pushtetit gjyqësor. Ky kontroll gjyqësor realizohet në kuadër të rritjes së cilësisë së drejtësisë dhe nuk ka si qëllim në vetvete, përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve. Ndryshimi apo prishja e një vendimi gjyqësor nga një gjykatë më e lartë, nuk mund të përbëjë apriori bazë të mjaftueshme faktike për procedimin disiplinor të magjistratit, nëse nuk shoqërohet me elementë të tjerë, të cilat tregojnë se magjistrati ka vepruar në keqbesim, duke çeduar nga detyrimi për ushtrimin me dinjitet të detyrës në përputhje me ndërgjegjen për interpretimin e fakteve, në zbatim të normave të së drejtës.

Pavarësisht kësaj, në raste të ndryshme kur vendimmarrjet e gjykatave më të ulëta janë cënuar nga gjykata më e lartë, duke evidentuar vendimmarrje në kundërshtim të hapur dhe flagrant me ligjin, apo praktikën unifikuese të gjykatës së lartë, të cilat kanë sjellë diskreditim të pozitës dhe figurës së magjistratit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka iniciuar 25 hetime disiplinore dhe ka paraqitur kërkesat për procedim për 9 magjistratë, 7 gjyqtarë dhe 2 prokurorë duke kërkuar:

shkarkim nga detyra, për 3 magjistratë;

pezullim nga detyra për 1 magjistrat;

ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit, për 4 magjistratë;

vërejtje publike për një magjistrat.

Një moment tjetër, që duhet evidentuar në kompetencat dhe rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është dallimi i qartë, ndërmjet procedurës disiplinore dhe asaj penale. Kushtetuta dhe ligji i kanë dhënë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë atributet të qarta në kryerjen e procedurave të hetimit disiplinor ndaj magjistratëve, apo subjekteve të tjera të përfshira në fushën e kompetencës së këtij institucioni. Hetimi dhe procedura disiplinore nuk kanë natyrë penale, nuk kanë mjete kërkimi si një organ i ndjekjes penale, por është proces administrativ. Rregullat dhe procedurat që ligji ka parashikuar, i shërbejnë garantimit të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor ndaj magjistratit, që dyshohet se ka kryer shkeljen disiplinore dhe palëve të tjera pjesëmarrëse në këtë proces dhe nuk ofrojnë mekanizma për të evidentuar ekzistencën e një fakti penal. Jo pa arsye, legjislatori i kanë përparësi procedurave penale, civile apo administrative duke e detyruar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë të pezullojë hetim

min disiplinor, kur është duke u zhvilluar një hetim penal ndaj magjistratit për të njëjtat fakte.

Problematika në lidhje me organizimin dhe funksionimin e zyrave të prokurorive

Në funksion të bashkëpunimit ndërinstitucional me Prokurorinë e Përgjithshme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka mbajtur kontakte të vijueshme me këtë institucion dhe për këtë qëllim ka lidhur edhe një marrëveshje bashkëpunimi. Ankesat e referuara nga Prokurori i Përgjithshëm kanë shërbyer si të dhëna për iniciimin e verifikimeve dhe hetimeve disiplinore ndaj disa magjistratëve, të cilat janë konkluduar me propozimin e masave disiplinore, përfshirë dhe shkarkimin nga detyra.

Njëkohësisht, veprimtaria e zyrave të prokurorisë, në drejtim të zbatimit të akteve rregullatore në marrëdhënie me drejtuesin ka qenë objekt inspektimi tematik. Ky inspektim ka patur qëllim zbatimin e urdhrave të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi ruajtjen e qëndrueshmërisë së organit të prokurorisë, përmes kohezionit institucional dhe uniformitetit të veprimtarisë në të gjitha prokuroritë, në garantimin e pavarësisë funksionale të prokurorit në vendimarrje për çështje konkrete. Ky inspektim vlerësohet të vijohet edhe në vazhdim, pasi nga monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna, por edhe nga verifikimet e kryera në kuadër të procesit të shqyrtimit të ankesave janë konstatuar përsëri problematika.

Në përmbushje të detyrimit ligjor për inspektimin e ndarjes së çështjeve me short në zyrat e prokurorive, ILD ka rekomanduar rishikim të aktit rregullator "Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori" dhe unifikim të praktikave të ndryshme të evidentuara gjatë kryerjes së inspektimit, në zyrat e prokurorive pranë Gjykatave të Juridiksionit të Përgjithshëm.

Ky inspektim referuar detyrimeve ligjore do të vijohet, duke patur në fokus monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

Produktiviteti në zhvillimin e seancave

Marrë shkas nga disa ankesa, të cilat i janë nënshtruar verifikimit, por edhe informacionit të paraqitur nga vetë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, një problematikë e sistemit gjyqësor sot është produktiviteti dhe efektiviteti i magjistratëve në planifikimin dhe zhvillimin e seancave gjyqësore, si dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive. Për adresimin e kësaj situatë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur kryerjen e një inspektimi tematik në disa gjykata të juridiksionit të përgjithshëm, me qëllim inspektimin e mënyrës së planifikimit të seancave gjyqësore dhe menaxhimit të shqyrtimit të çështjeve sipas kategorive përkatëse, në përputhje me afatet e vendosura nga dispozitat procedurale. Një faktor që ndikon në normën e pamjaftueshme të evadimit të çështjeve gjyqësore, siç e kemi evidentuar edhe në raportet tona të inspektimit tematik, është mosplotësimi i vakancave në gjykatat e shkallës së parë dhe në veçanti në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit. Ky proces, siç evidentohet është i lidhur me mospërfundimin në kohë të procedurave të vlerësimit etiko-profesional të magjistratëve. Në këtë kuadër, vlerësojmë të nevojshëm marrjen e masave konkrete për të rritur efektivitetin e këtij procesi duke orientuar dhe bashkëpunimin e Këshillave në aplikimin e standardeve uniforme të vlerësimit nën dritën edhe të orientimeve të dhëna nga vendimarrja e Gjykatës së Lartë.

Të nderuar deputetë!

Pavarësisht rezultateve të deritanishme, institu-

Ngarkesa e jashtëzakonshme e punës dhe numri i lartë i çështjeve gjyqësore, mbetet një ndër sfidat më serioze, që cenon cilësinë dhe kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, si dhe të drejtat e shtetasve shqiptar në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Në këtë drejtim, kërkohet angazhimi i përbashkët i të gjithë organeve publike, si Kuvendi, Këshillat, Prokurori i Përgjithshëm, gjykatat apo dhe zyrat e prokurorive për hartimin e masave konkrete për reduktimin e backlog-ut; rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, plotësimin e organikave, shtimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e infrastrukturës.

cioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konstaton, se sistemi i drejtësisë përballlet me sfida të rëndësishme, që lidhen me organizimin dhe funksionimin e tij. Efektiviteti dhe cilësia e sistemit të drejtësisë nuk janë në nivelin, që i përgjigjet pritshmërive të qytetarëve shqiptarë. Kjo është pjesë e procesit të konsolidimit të Reformës në Drejtësi dhe një përgjegjësi e të gjithë organeve tona, duke filluar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, organet e qeverisjes së pushtetit gjyqësor, apo magistratët gjyqtarë dhe prokurorë.

Një aspekt që kërkon vëmendje të veçantë është infrastruktura e pushtetit gjyqësor. Mungesa e ambienteve të përshtatshme dhe aplikimi i teknologjisë së informacionit, përfshirë sistemet e regjistrimit audio të seancave, sistemet e menaxhimit të çështjeve, arkiva, qarkullimi i dokumentacionit procedural dhe administrativ, apo sisteme teknologjike që mbulojnë procese të veçanta të punës së gjykatës apo prokurorisë, ndikojnë drejtpërdrejt, në cilësinë dhe solemnitetin e gjykimit apo zhvillimit të procesit të hetimit penal. Në disa raste, këto kushte kanë ndikuar edhe në sjelljen etiko-profesionale të magistratëve, duke ekspozuar sistemin e drejtësisë ndaj perceptimeve negative nga publiku. Për këtë arsye, investimi në infrastrukturë duhet të shihet si pjesë e pandarë e politikave për forcimin e pavarësisë, legjitimitetit dhe integritetit të pushtetit gjyqësor.

Ngarkesa e jashtëzakonshme e punës dhe numri i lartë i çështjeve gjyqësore, mbetet një ndër sfidat më serioze, që cenon cilësinë dhe kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, si dhe të drejtat e shtetasve shqiptar në kuadër të një procesi të rregullt ligjor. Në këtë drejtim, kërkohet angazhimi i përbashkët i të gjithë organeve publike, si Kuvendi, Këshillat, Prokurori i Përgjithshëm, gjykatat apo dhe zyrat e prokurorive për hartimin e masave konkrete për reduktimin e backlog-ut; rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, plotësimin e organikave, shtimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e infrastrukturës. Njëkohësisht, vetë gjykatat dhe zyrat e prokurorisë duhet të hartojnë sisteme të priorizimit të çështjeve, për të siguruar një trajtim më të shpejtë dhe të drejtë të dosjeve gjyqësore.

Sistemi llogaridhënës përbën gurin e themelit për një shtet të së drejtës. Vetëm nëse ky sistem funksionon në mënyrë të plotë, të drejtë dhe efektive, pushteti gjyqësor mund të organizohet mbi baza të qëndrueshme profesionalizmi, integriteti dhe legjitimiteti. Në të kundërt, një sistem përgjegjësie që funksionon vetëm në aspektin ndëshkues e jo parandalues, humbet rolin e tij edukues dhe kontribuon në uljen e besimit publik. Llogaridhënia e pushtetit gjyqësor duhet të perceptohet si një mekanizëm parandalues dhe përmirësimi, jo si mekanizëm intimidimi, ndërhyrje apo ndëshkimi.

Roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet të shihet thjesht në aspektin disiplinor, por në një prizëm më të gjerë edukues dhe parandalues. Qëllimi është të krijohet një kulturë e lartë etike dhe profesionale në sistemin e drejtësisë, ku ndjenja e llogaridhënies të jetë pjesë e vetëdijes së magistratëve dhe jo një faktor i jashtëm. Nëse sistemi i përgjegjshmërisë, pra shkollimi në Shkollën e Magistraturës, emërimet dhe promovimet e magistratëve nga Këshillat, roli i gjykatave më të larta për rritjen e cilësisë së vendimeve gjyqësore, etj, funksionon në mënyrë të plotë, të drejtë dhe efektive, atëherë pushteti gjyqësor do të organizohet dhe do të funksionojë mbi baza të qëndrueshme profesionalizimi, legjitimiteti dhe të integritetit. Në rast të kundërt, nëse ky sistem nuk funksionon, aplikimi i sistemit të përgjegjësisë së magistratëve (pra, sanksionet) mund të jetë një mekanizëm dhe reagim i vonuar, duke mos luajtur një rol parandalues, por vetëm ndëshkues, si dhe duke sjellë si pasojë, jo vetëm cenimin e besimit të publikut në pushtetin gjyqësor, por edhe legjitimitetin apo autoritetin e këtij pushteti.

Ky është dimension i vërtetë dhe filozofia e një reforme legjitime në një sistem drejtësie: ndërtimi i një sistemi drejtësie, që vetërregullohet përmes integritetit të tij. Ky diskutim na çon drejt një dileme universale, që hasin shumë shtete: balancimi midis pavarësisë dhe llogaridhënies. Edhe në Shqipëri, ku sistemi i drejtësisë është ende në fazë konsolidimi pas reformimit të thellë institucional, ky ekuilibër kërkon kujdes të veçantë. Nga njëra anë, duhet të mbrohet pavarësia funksionale e magistratit, si themel i shtetit të së drejtës, ndërsa nga ana tjetër, duhet të garantohet, që kjo pavarësi të mos shndërrohet në mungesë përgjegjësie.

Sfida më e madhe e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë sot është ruajtja e pavarësisë së tij institucionale dhe siguri i një roli konstruktiv

në garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Jo si një lojë fjalësh dhe jo si mburojë për paligjshmeritë eventuale që mund të kryejë sistemi. Por, si një parim i rëndësishëm për të ardhmen e vendit, si një parim, që tregon se sistemi llogaridhënës ndaj magistratëve nuk është zgjedhje apo emocion, aq më pak i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Por, është parim mbi të cilin bazohet një shtet ligjor. Në një kontekst ku ndërhyrjet e drejtpërdrejta apo të tërthorta ndaj gjyqësorit nuk janë të panjohura, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka detyrimin të dëshmojë integritet, transparencë dhe paanshmëri, në çdo vendimarrje. Ky është një proces i ndjeshëm, ku institucioni duhet të veprojë si mbrojtës i parimeve të drejtësisë, por jo si faktor që ndikon, apo orienton vendimarrjen e pushtetit gjyqësor. Në këtë proces, Inspektori i Lartë i Drejtësisë do të vijojë të zbatojë me përkushtim, standardet më të larta të procesit të rregullt ligjor, si dhe të jetë garant i ekuilibrit midis pavarësisë dhe llogaridhënies në sistemin gjyqësor shqiptar.

Sot po përballemi me një paqartësi mbi rolin dhe funksionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që nuk rrjedh vetëm nga qytetarët, të cilët nëpërmjet ankesave të paraqitura në ILD pretendojnë zgjidhje të mosmarrëveshjeve gjyqësore, ndërhyrje në procese gjyqësore, apo ndikim në vendimarrje gjyqësore, por haset edhe në kuadër të pretendimeve të shumta nga rrethet e tjera publike, ku përfshihen aktorët politikë, media apo dhe vetë organet të tjera publike.

Ky fenomen kërkon një adresim në aspektin sistematik. Një rëndësi thelbësore në garantimin e një sistemi cilësor drejtësie ka edhe Gjykata e Lartë, si organi më i lartë në piramidën e hierarkisë gjyqësore, jo vetëm nëpërmjet zgjidhjes së konflikteve, por dhe në sigurimin e shmangies së divergjencave dhe ruajtjen e qëndrueshmërisë në interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Për këtë arsye, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkon një vëmendje të veçantë nga

ana e Gjykatës së Lartë, për të ushtruar rolin e saj njehsues, në vendosjen e standardeve dhe praktikave të qëndrueshme.

qytetarin, më të qartë në funksionet e saj dhe më të besueshme në rezultatet që prodhon apo që ka detyrim ligjor të prodhojë.

Njëkohësisht besoj, se procesi i edukimit ligjor të publikut, përbën një parakusht të domosdoshëm për konsolidimin e besimit në drejtësi. Një publik i informuar, i ndërgjegjshëm dhe aktiv është partneri më i vlefshëm i institucioneve të drejtësisë. Këtu një rol thelbësor duhet të luajë edhe Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, në kuadër të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut.

Nëse qytetarët nuk e kuptojnë rolin e institucioneve të drejtësisë, magjistratëve, kufijtë e kompetencave të institucioneve dhe mekanizmat e ankimit, sistemi i drejtësisë rrezikon të perceptohet si i mbyllur dhe i pakuptueshëm. Sot po përballemi më një situatë shqetësuese, ku faktorët, të cilët kanë ndikuar në krijimin e saj mund të jenë të ndryshëm. Por mungesa e reagimit dhe marrjes së masave nga ana jonë për të parandaluar këto fenomene negative mund të sjellin pasoja të rënda, jo vetëm për sistemin e drejtësisë, por edhe për vetë shoqërinë tonë. Për këtë arsye, personalisht mendoj se të gjitha organet tona duhet të vijojnë më tej përpjekjet dhe të investojnë në transparencë, edukim ligjor dhe komunikim publik, duke e bërë drejtësinë më të afërt me

Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ofron angazhim maksimal, që të zhvillojë një kulturë bashkëpunimi dhe koordinimi institucional, ku të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë si KLGJ, KLP, Gjykata e Lartë, Shkolla e Magjistraturës, apo dhe organet e tjera, si Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, të punojnë mbi plane veprimi strategjik të përbashkëta për përmirësimin e cilësisë së drejtësisë dhe forcimin e besimit të qytetarëve. Ky proces kërkon vizion afatgjatë, plan të strukturuar zbatimi dhe një vlerësim të vazhdueshëm të rezultateve, në mënyrë që çdo rekomandim të shndërrohet në realitet institucional. Rruga drejt një sistemi drejtësie efikas dhe të qëndrueshëm kërkon bashkërendim institucional, transparencë dhe respekt të parimit të ndarjes së pushteteve. Vetëm përmes bashkëpunimit dhe përkushtimit të përbashkët, mund të garantojmë një sistem drejtësie që i shërben qytetarit. Vetëm në këtë mënyrë, drejtësia shqiptare do të mund të funksionojë mbi themele të qëndrueshme profesionalizmi, integriteti dhe besueshmërie.

Ju faleminderit!

Institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ofron angazhim maksimal, që të zhvillojë një kulturë bashkëpunimi dhe koordinimi institucional, ku të gjitha institucionet e sistemit të drejtësisë si KLGJ, KLP, Gjykata e Lartë, Shkolla e Magjistraturës, apo dhe organet e tjera, si Kuvendi dhe Ministria e Drejtësisë, të punojnë mbi plane veprimi strategjik të përbashkëta për përmirësimin e cilësisë së drejtësisë dhe forcimin e besimit të qytetarëve.



DEKLARATË PËR MEDIA

Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh tronditjen e thellë nga vrasja e gjyqtarit Astrit Kalaja në krye të detyrës, brenda ambienteve të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe plagosja e dy qytetarëve nga të shtënat me armë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë shpreh ngushëllimet më të ndjera familjes, të afërmeve, kolegëve dhe miqve të gjyqtarit Astrit Kalaja. Uroj shërim të shpejtë për të plagosurit e këtij akti kaq të rëndë.

Tragjedia e sotme, që i mori jetën një magjistrati prek të gjithë trupën gjyqësore, sistemin e drejtësisë, shtetin e

së drejtës dhe çdo institucion publik.

Siguria duhet të jetë prioritet absolut për të gjithë. Në institucionet e sistemit të drejtësisë dhe çdo instancë shtetërore ligjzbatuese duhet të angazhohemi pa humbur kohë në garantimin e paprekshmërisë së çdo përfaqësuesi të drejtësisë, që ushtron detyrën në emër të ligjit.

Duke shprehur solidaritetin me trupën gjyqësore, inkurajoj çdo gjyqtar e çdo prokuror, që përtej ngjarjes së rëndë, të vazhdojë detyrën duke zbatuar ligjin.



FORCIMI I KAPACITETEVE TË ILD NË HETIMIN DISIPLINOR DHE INSPEKTIMET

Njësia e inspektorëve dhe ajo e ndihmës inspektorëve e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilluan një trajnim dy-ditor mbi hetimin disiplinor dhe inspektimet me fazat konkrete të procedimit, me praktikën e homologëve nga Italia e Spanja, bazuar në modelet e punës së deritanishme të inspektimeve nga ILD.

Trajnimi u realizua nga dy ekspertë ndërkombëtarë afatshkurtër, prokurorja María del Carmen de la Fuente Méndez, pjesë e Inspektoratit Spanjoll dhe ish-prokurorja Annita Sorti, ish-anëtare e Inspektoratit të

Përgjithshëm Italian, me mbështetjen e misionit EU4Justice.

Trajnimi pati në fokus diskutime dhe punë në grupe mbi kriteret e përzgjedhjes së zyrave të prokurorive për inspektim, analizën e të dhënave paraprake të inspektimit, stoku i çështjeve, performanca e stafit, tendencat e ankesave, përgatitja e mjeteve të inspektimit, komunikimi me zyrat subjekt inspektimi përpara vizitës dhe planifikimi duke identifikuar fushat problematike, etj.

Përvoja spanjolle dhe italiane u përdor



edhe me modelin e strukturimit të raportit lënë pas edhe komunikimin e gjetjeve me të inspektimit: gjetjet, provat, rëndësia e transparencë, duke ruajtur besimin instituci- çështjeve, dhënia e rekomandimeve onal. afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, identifikimi i praktikave më të mira dhe Pjesa teorike u kombinua me studime pozitive, mekanizmat e ndjekjes dhe afatet rastesh nga praktikat evropiane mbi in- për zbatim dhe ndarja e përgjegjësi, pa spektimet tematike dhe institucionale.



FOTO NGA AKTIVITETI





KLP NUK PRANON KËRKESËN E ILD PËR MASË DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATES A.K.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë rrëzoi në mbledhjen e sotme propozimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për caktimin e masës disiplinore “Vërejtje publike” ndaj prokurorisë A.K., e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për shkelje të dispozitave, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave/prokurorisë dhe shkelje të rregullave të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi në proces ose i përfunduar.

Nga raporti hetimor i ILD-së rezultoi se magjistratja A.K. ka nënshkruar shkresa pa patur kompetencë, nxjerrë dhe dërguar të

tretëve kopjeje të disa akteve, pjesë të dosjes së një çështjeje në proces hetimi, duke shpërfillur autoritetin e titullarit të prokurorisë, cenuar imazhin e zyrës së prokurorisë, teksa publikimi i akteve procedurale mbart rrezikun e ardhjes së pasojave në dëm të hetimit dhe për rrjedhojë humbjen e besimit të publikut për funksionimin e Prokurorisë sipas ligjit dhe jo dëshirës së magjistratit.

Në raportin hetimor të ILD, evidentohet se ligji nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë parashikon mes të tjerash se:

1- Prokurorët dhe gjithë personeli i prokuro-

Prokurorët dhe gjithë personeli i prokurorisë, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si edhe pas përfundimit të saj, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin shtetëror për fakte për të cilat vijnë në dijeni, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

risë, gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si edhe pas përfundimit të saj, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin shtetëror për fakte për të cilat vijnë në dijeni, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

2- Prokurorisë nuk i lejohet të bëjë publike ose t'u japë personave të tretë të dhëna që dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, të drejtat e të miturve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

3 – Prokurorëve u ndalohet të bëjnë deklarata ose të japin mendime për veprimtarinë e organeve të tjera.

Duke mbajtur në konsideratë natyrën e shkeljes disiplinore, ekzistencën e rrethanës lehtësuese, lidhur me shkeljen për herë të parë, përvojën 2 vjeçare në funksionin e prokurorës, cënimin e imazhit të prokurorisë dhe besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, ILD konkludoi se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistrates përbëjnë "Shkelje disiplinore e lehtë", sipas nenit 102 pika 1 shkronjat "g" dhe "j" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe i propozoi KLP-së caktimin e masës disiplinore "Vërejtje publike" ndaj znj. A.K., kërkesë që u rrëzua nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Prokurorisë nuk i lejohet të bëjë publike ose t'u japë personave të tretë të dhëna që dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, të drejtat e të miturve, si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.

TETORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Tetor 2025** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **188 ankesa nga ta cilat 183 të depozituara nga qytetarë dhe 5 (pesë)** nga institucione. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Tetor 2025**.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
60 vendime nga 75 praktika të trajtuara: • 44 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar; • 16 vendime arkivimi pas Verifikimit	• 15 vendime verifikimi	• 3 vendime për fillim hetimi disiplinor për 3 magjistratë (2 gjyqtarë, 1 prokuror)

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD,

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Tetor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, **për 4 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit **Tetor 2025**,
Sektori i Ankesave dhe
Marrëdhënieve me Publikun:

- ⇒ **ka pritur 44 ankues,**
të cilët janë paraqitur në ambi-
entet e Zyrës së Inspektorit të
Lartë të Drejtësisë;
- ⇒ **ka realizuar 26 telefonata me**
qytetarë, të cilët kanë
kërkuar informacion mbi
fazën e ankesave të tyre ose
Informacion mbi plotësimin e
formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohet nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: **info@ild.al**, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit **amanta.jasa@ild.al**.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE


*Gjatë muajit **Tetor 2025**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **25 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ILD NË TWITTER

Roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk duhet të shihet thjesht në aspektin disiplinor, por në një prizëm më të gjerë edukues dhe parandalues. #ILD #kuvend#veprimtariavjetore



- ✓ 8227 të konfirmuara
 - ✓ 6268 të trajtuara
 - ✓ 1959 në proces trajtimi
 - ✓ 121 në proces verifikimi
 - ✓ 141 magjistratë të hetuar
 - ✓ 53 kërkesa për procedim disiplinor
 - ? Keni patur eksperiencë me ne? Na thoni 📌 📌
- ild.al/sq/ankete/



#transparency #HIJ #parliamentofAlbania


Q&A session of the High Inspector of Justice, Mr. Artur Metani, with Members of Parliament. 📌



Pavarësisht rezultateve të deritanishme #ILD konstaton se sistemi i drejtësisë përballet me sfida të rëndësishme që lidhen me organizimin e funksionimit të tij. Efektiviteti dhe cilësia e sistemit nuk janë në nivelin që i përgjigjet pritshmërive publike 📌



- ✓ 1840 in processing
 - ✓ 127 in verification process after initial review
 - 📌 More ild.al
 - ? Have you had an experience with us? 📌 📌
- ild.al/sq/ankete/



@ILD_Albania

Eksperienca italiane dhe ajo spanjolle për inspektimet e #ILD #forcimkapacitetesh 📌



Tetor 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara

© ILD


**KONTAKT ILD**

WEB: ild.al

Tel: +35542217217

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD

Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

[youtube.com](https://www.youtube.com)

*[Kliko](#) për të ndjekur spotin
prezantues të ILD*



Më skano!